



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Teknik i Lartë” me tre profile: Sisteme kompjuterike; Sisteme elektrike dhe Sisteme motorike”
NË KOLEGJIN UNIVERSITAR TË BIZNESIT (KUB)**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Aida Spahiu

2. Dr. Miranda Harizaj

Nëntor/2020

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) është institucion i arsimit të lartë jo publik, i cili është licencuar me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011, me emërtimin “Akademia Profesionale e Biznesit”.

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit Nr. 39, datë 30.01.2018, Institucioni **Akademia Profesionale e Biznesit** ka ndërruar statusin ligjor duke u shndërruar në **KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT (KUB)**.

KUB ofron studime Bachelor, Master dhe Studime të Larta Profesionale. **Institucioni** është akredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite, me vlefshmëri deri më **09.11.2021**.

Kolegji Universitar i Biznesit ka 3 njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë
2. Fakulteti i Drejtësisë
3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, me dy njësi kryesore:
 - Departamenti i Studimeve të Larta Administrative
 - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike

Programi i studimit “Teknik i lartë” me tre profile: sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sisteme motorike mbështetet nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale.

Njësia kryesore "**Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale**" (KSLP) është hapur me Urdhër të MASR Nr. 139, datë 23.03.2018.

Programi i studimit “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sisteme motorike është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 355, datë 28.06.2018, me elementët si mëposhtë:

1. Program studimi 2 vjeçar me karakter profesional pas arsimit të mesëm
2. Kohëzgjatja (vite/semestra): **2 vite/4 semestra**
3. ECTS totale : **120 kredite (ECTS)**
4. Forma e studimit: **me kohë të plotë**
5. Gjuha e programit të studimit **gjuha shqipe**
6. Diploma lëshohet vetëm nga **KUB**
7. Numri i studentëve për vit akademik parashikohet **70 – 120 studentë.**

Niveli i diplomës në kuadër e Kornizës Shqiptare të kualifikimeve është **Niveli 5**.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

(200-400 fjalë)

Vlerësimi i jashtëm për këtë program studimi me karakter profesional është mbështetur nga vizita në Institucion dhe nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit të vënë në sistem nga KUB.

Në fillim jemi njohur me dokumentacionin e vënë në sistem dhe më tej kemi vazhduar me vizitën në Institucion.

Gjatë vizitës në Institucion kemi realizuar takime të ndryshme në përputhje me axhendën e vizitës, për të cilën ishte rënë dakort paraprakisht me titullarët e Institucionit.

Takimi i parë u realizua me Koordinatorin teknik të ASCAL dhe atë Institucional për të bashkërenduar punën.

Më tej u vazhdua me takimin me Drejtorin e Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, Dr. Ardi Bezo dhe Drejtuesin e Departamentit të Studimeve të Larta Teknike, Prof. Asc. Asllan Hajdëri. Në këtë takim u dha një informacion i përgjithshëm në lidhje me Institucionin, duke u përqëndruar tek KLPS. U informuam që studentët që në vitin e parë regjistroheshin të ndarë sipas profileve. Për secilin profil kishin nga një laborator të dedikuar, një për sistemet elektrike, një për sistemet motorrike dhe një laborator të informatikës për sistemet kompjuterike. U informuam që programi i studimit ka rregulloren e tij, rregullore të provimeve dhe për marrëdhëniet e punës, numrin e studentëve në këtë program studimit, nga cilat shkolla të mesme vinin, mesataren e tyre etj. Programi i studimit ka filluar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. Në vitin 2019-2020 janë bërë ndryshime të programit të studimit, të miratuara një vit më parë.

Në vitin akademik 2019-2020 për shkak të pandemisë semestri i dytë është zhvilluar online dhe Institucioni ka vënë në përdorim portalin e tij për zhvillimin e mësimin online nëpërmjet google classroom.


Më tej u zhvillua takimi me grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB) ku u mor informacion më i hollësishëm në lidhje me këtë program studimi.

Në takimin e zhvilluar me stafin akademik të programit të studimit u informuam në lidhje me format e mësimdhënies, interaktiviteti pedagog-student, mënyrën si si janë punësuar, a ndjehen të motivuar, nëse institucioni i mbështet në punën e përditshme dhe në kualifikimin e tyre etj.

Më tej u zhvillua takimi me studentët ku morëm informacion në lidhje me format e mësimdhënies dhe cila prej tyre i pëlqen më shumë dhe i ndihmon të përvetësojnë më mirë lëndën, praktikat mësimore, laboratorët, zhvillimin e provimeve etj.

Takime të tjera të rëndësishme ishin ato me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sekretarinë mësimore, zyrën e burimeve njerëzore ku u shqyrtuan dhe dokumentacionet përkatëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm vizitoi gjithashtu klasat, laboratorët, bibliotekën dhe ambiente të tjera për të vlerësuar infrastrukturën, që përdoret gjatë zhvillimit të procesit mësimor të programit të studimit.



RVJ mbas komenteve të KUB

Mbështetur në shkresën përcjellëse të Rektorit Prof. Dr. Leandro Haxhi “Mendime mbi Draft raportin e GVJ për vlerësimin e programit profesional “Teknik i Lartë” në KUB ju sqarojmë:

1. **Kolegji Universitar i Biznesit (KUB)** është institucion i arsimit të lartë jo publik i cili është licencuar me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe si i tillë i gjithë vlerësimi i GVJ është mbështetur në LAL 80/2015 dhe të gjithë bazën ligjore të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
2. GVJ ka detyrë funksionale shqyrtimin e hollësishëm të të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL krahasuar me bazën ligjore në fuqi për Arsimin e lartë, në mënyrë që të japë vlerësime objektive dhe profesionale për plotësimin e standarteve të kërkuara për programin e studimit me karakter profesional. Cilësimi në shkresë nga ana e IAL se qëndrimet dhe vlerësimet e anëtarëve të GVJ janë më shumë të ndikuara nga një qëndrim subjektiv nuk qëndron.
3. GVJ përpara vizitës në Institucion ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e vendosur në system nga IAL dhe ka kërkuar gjatë vizitës dokumentat shtesë në mbështetje të vlerësimit të përmbushjes së kriterëve dhe standarteve të këtij programi studimi dhe përgatitjes së raportit. Dokumentat plotësuese dhe të konstatuara me mungesë faqesh gjatë skanimit, të sjella nga KUB në funksion të rishikimit të vlerësimit nga ekspertët të kriterëve dhe standarteve të caktuara për të cilët KUB ka sjellë komente, janë vlerësuar në mënyrë të hollësishme nga ekspertët.
4. Konstatojmë që ka mospërputhje të kohës së hapjes së programit të studimit pasi në Shtojcën e sjellë të Strategjisë, **tetor 2018, faqe 2**, përcaktohet që KUB do të propozojë, çeljen e programeve të reja me karakter profesional, ndërkohë që Programi i studimit “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sisteme motorike është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë **Nr. 355, datë 28.06.2018**.

Mbështetur në dokumentacionet plotësuese dhe të saktësuara të sjella nga KUB mëposhtë po ju paraqesim në mënyrë të hollësishme se cilat kriterë janë marrë parasysh dhe cilat jo me argumentimet përkatëse, në raportin e rishikuar nga GVJ.

1. Standardi I.1:

Kriteri 1. Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, duke patur parasysh shtojcën e strategjisë sjell nga KUB.

Kriteri 2. Ka ngelur i njëjtë në formulim se dhe në variantin e skanuar saktë, të dërguar të Statutit të KUB nuk jepen prioritet akademike të KUB. Në RVJ janë hequr shprehjet “Në materialin e statutit të vendosur në sistem mungojnë nenet e para deri tek neni 5” dhe “Në rregulloren e Institucionit të vendosur në sistem ka zhvendosje dhe mospërputhje të neneve nga neni 50 e tutje”.

Kriteri 4. Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, pas dërgimit nga KUB të materialit të plotë dhe të saktë mbi studimin e tregut.

Kriteri 6: Është marrë parasysh pjesërisht, janë shtuar marrëveshjet e tjera të bashkëpunimit. Sqarojmë se në këtë kriter nevojiten “Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre”, të cilat mungojnë.

2. Standardi I.2:

Kriteri 3: Mbetet formulimi sic ka qenë, pasi plani mësimor vitit akademik 2018 -2019 nuk mund të ndryshohet në atë vit akademik, Vendimi Senatit Nr. 25 datë 13.03.2019 ndërsa MASR për këtë ndryshim është njoftuar me shkresën Nr. 173, datë 06.05.2019. Pra nuk ka sitë zhvillohet praktika në semestrin e dytë të vitit të parë, viti akademik 2018-2019. Ndryshimet në planin mësimor reflektohen në vitin pasardhës 2019-2020, evidence 52, procedurat mbi ndryshimin e kurrikulës.

Kriteri 4: Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, me plotësimin e marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit sjellë nga institucioni.

3. Standardi I.3:

Kriteri 3: Mbetet formulimi sic ka qenë, referencë arsyetimi në Kriterin 3 të Standartit I.2. Praktika e kryer është realizuar jo në përputhje me planin mësimor të aprovuar për vitin akademik 2018-2019 nga të gjitha instancat e KUB.

Përmbajtja e lëndës Sisteme elektrike, ku flitet në përgjithësi për linjat e transmetimit të TN, TM dhe TU, rrjetin e shpërndarjes dhe vlerësimi i ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes, stabiliteti i tensionit, deformimi i kurbës së tensionit etj që nuk përputhen me instalimet elektrike. Punët praktike të vëna në të nuk janë në përputhje me temat e leksioneve përkatëse. Kjo ka qenë arsyeja e kërkesës së bërë në RVJ.

Kriteri 5:

- a) Mbetet formulimi sic ka qenë. E kemi sqaruar që në fillim të këtij dokumenti që KUB është institucion i arsimit të lartë jo publik prandaj GVJ i referohet të gjitha përcaktimeve të LAL 80/2015, neni 21, pika 4 si dhe të gjithë kornizës ligjore në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 21, pika 4: “Kolegji profesional i lartë mund të ngrihet edhe pranë institucioneve të arsimit të lartë, që kanë statusin e universiteteve dhe kolegjeve universitare. Në këto raste ai konsiderohet si njësi kryesore e institucionit. *Në të gjitha rastet e tjera kolegji profesional i lartë konsiderohet njësi e veçantë e arsimit të lartë*”.

Sqarojmë se mbështetur në verifikimin e bërë në sistem date 08.04.2020 si dhe shtojcen 4 të dokumentave shitesë të sjella nga KUB rezulton se personeli ndihmës akademik, laborant, Leonard Koçi është me diplomë universitare Bachelor.

- b) Sqarojmë se është shkruar vetëm për anëtarët e departamentit DSTL ” Ky Departament ka në përbërjen e tij, referencë Nr. 24, tabelat plotësuese për RVB dhe referencë CV stafi ...”.

Më tej në llogaritjen e ngarkesës mësimore janë marrë parasysh të gjithë pedagogët PAE, që nuk janë pjesë e DSTL por e Departamenteve të tjera në KUB.

Në RVJ është shtuar fjalia "PAE e DSTL së bashku me njësitë e tjera bazë të KUB, të cilët japin mësim janë në raport 10PAE/15PAK, 40%/60%.

c) Ndërkohë megjithëse Dr. Besnik Hajdari ka kërkuar dorëheqje dhe është larguar për arsye shëndetsore, f.4 pika c, pra nuk është më pjesë e DSTL, GVJ e ka marrë parasysh në numrin e anëtarëve të Departamentit, duke pranuar informacionin e verifikuar në sistem datë 8.04.2020. Gjithashtu siç shkruhet dhe në shkresën e KUB, faqe 4 pika c) pedagogu PAE Dr. Besnik Hajdari është larguar para fillimit të semestrit të dytë dhe për këtë është ngarkuar staf PAK E. Hoxha si dhe mbingarkuar PAH Msc. Sh. Shefiti.

d) GVJ ka rillogaritur ngarkesën mësimor në bazë të dokumentave shtesë të vëna në dipozicion nga KUB dhe e ka reflektuar në raport. Në këtë pjesë kemi konstatuar që ngarkesa mësimore e vënë në planin mësimor 2019 - 2020 nuk është e njëjtë me atë të tabelës vënë në dispozicion për shembull:

- Lendet: Materiale elektroteknike dhe Sisteme elektrike në plan mesimor 53 ore secila ndersa ne tabelen e ngarkeses 45 ore secila.

- Lenda: Matje në plan mesimor 53 ore ndersa ne tabelen e ngarkeses 45 ore

- Lëndët: Sistemet e drejtimit dhe suspensionit dhe MDB në plan mesimor 53 ore secila ndersa ne tabelen e ngarkeses 45 ore secila.

- Lëndët Elektronike dhe Automatizim në plan mesimor 53 ore secila ndersa ne tabelen e ngarkeses 45 ore secila.

Janë marrë në konsideratë orët mësimore të planit mësimor pasi përputhen me numrin e krediteve të vendosur në të.

e) LAL 80/2015 i nënshtrohen të gjitha Institucionet e Arsimit të lartë publike dhe jo publike, gjë e cila është e reflektuar qartësisht dhe në Statutin e KUB, neni 47 "Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik". Mbetet i njëjti formulim siç është.

Nga RVJ është hequr fjalia "Tabela 12.1, të cilës i jemi referuar ka pasaktësi pasi staf që është PAK është vendosur në tabelë si PAE, psh. A. Mushketa, D. Karriqi, G. Muça, V. Topulli etj."

Ky standart është shumë i rëndësishëm se lidhet me sasinë dhe cilësinë e personelit akademik në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor prandaj është vënë ai vlerësim.

4. Standardi II.1:

Kriteri 3. Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, për planet mësimore 2019-2020, pasi dërgimit të tyre me shtojcën Nr.5. Është shtuar komenti i mëposhtëm, sipas gjetjeve në planin mësimor 2019-2020 të dërguar nga KUB:

1. Nga plani mësimor 2019-2020 për profilin sisteme elektrike konstatojmë se:

- lënda Materiale Elektroteknike zhvillohet dhe vitin I semestri I, lënda me Nr.5 dhe vitin e II, semestri parë, lënda me Nr.1.

- E njëjta gjë ka ndodhur dhe me lëndën Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 2;
2. Për sisteme motorike:
- lënda Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 5.
 - Lëndët Anglisht III dhe Ndërtim shasie, të cilat janë hequr me ndryshimet në planet mësimore për vitin 2019-2020 kanë mbetur në planet mësimore të dërguara, referencë Vendimi Senatit Nr. 25 datë 13.3.2019.
3. Për sistemet kompjuterike:
- lënda Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 5.
 - Lëndët: Matje, English III dhe English IV të cilat janë hequr me ndryshimet në planet mësimore për vitin 2019-2020 kanë mbetur në planet mësimore të dërguara, referencë Vendimi Senatit Nr. 25 datë 13.3.2019.
 - Lënda Administrim ndërmarrje, për të cilën është dërguar syllabusi nuk gjendet në planin mësimor të vitit 2019-2020.

Kriteri 4. Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, duke hequr nga listimi lëndët për të cilat u sollën syllabuset, referuar shtojcës 5.

Kriteri 5. Nuk e kuptojmë vërejtjen e bërë pasi në këtë kriter kemi folur vetëm për planet e ndryshuara për vitin akademik 2019-2020 dhe jo 2018-2019.

5. Standardi II.2

Kriteri 4. Ju lutem referojuni shënimit poshtë tabelës 1.1, VKM 879, datë 18.12.2019.

6. Standardi II.3



Kriteri 1. Është lënë i njëjti formulim pasi sqarojmë se ndryshimet e planit mësimor 2019-2020, prekin për lëndët e vitit të dytë studentët të cilët kanë filluar programin e studimit 2018-2019 dhe për lëndët e vitit të parë studentët, të cilët e kanë filluar këtë program studimi në vitin 2019-2020. Nuk ka arsye të ketë syllabuse të reja për vitin 2020-2021.

Kriteri 2. Mbetet i njëjti formulim. Arsyetimin e kemi dhënë më sipër.

Kriteri 5. Mbetet i njëjti formulim. Sqarojmë se në këtë kriter nuk ka ndonjë konvertim të praktikës.

7. Standardi III.4

Kriteri 1. Mbetet i njëjti formulim pasi Rregullorja e provimeve të KUB, tw cilws i referohet institucioni mungon dokumentat shtesë që ka vwnw në dipozicion.

8. Standardi III.5

Kriteri 6. Në RVJ është reflektuar sugjerimi i bërë nga KUB, pasi vënies në sistem të pyetjeve të provimit të formimit, shtojca 6.

9. Standardi IV.3

Kriteri 6. Është riformuluar konstatimi në këtë kriter ” GVJ konstaton që KUB duhet të gjejë mbështetjen financiare të nevojshme për të financuar plotësimin dhe përditësimin e bibliotekës mësimore të përshtashme dhe të plotë, në funksion të programit të studimit”, i cili është i lidhur me konstatimin në kriterin 3 të standartit ”GVJ konstaton se IAL duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës së programit të studimit, si dhe të përditësojë fondin ekzistues fizik të teksteve dhe abonimin në bibliotekën online në mbështetje të programit të studimit”.

10. Standardi IV.5

Kriteri 3. KUB disponon rregullore dhe procedura për menaxhimin e informacionit të brendshëm por nuk ka një sistem të brendshëm për regjistrimin dhe menaxhimin e informacionit dhe ky konstatim është bërë jo vetëm në kriterin 3, por dhe në kriteret e tjera 1, 2 dhe 5 të këtij standarti.

Mungesa dhe rëndësia e një sistemi të tillë është nënvizuar dhe konstatuar dhe në kriterin 4 të standartin V.3 “GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm ku ruhen, administrohen dhe përpunohen të gjitha të dhënat e studentëve, përfshirë dhe rezultatet e ecures në programin e studimit, gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore. Si e tillë siguria e informacionit që administrohet në IAL është e cënuar dhe jo lehtësisht e verifikueshme nga personat e autorizuar”

11. Standarti V.1

Kriteri 4. Pas konsultimit të rregullores së vënë në dispozicion u rishikua vlerësimi për këtë standart, i cili nuk ka ndikim në vlerësimin e përgjithshëm të kësaj fushe vlerësimi.







TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për Programin e studimit: Program profesional në "Teknik i Lartë" me tre profile:
Sisteme Kompjuterike; Sisteme Elektrike dhe Sisteme Motorike**



Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Studimeve të Larta Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	"Teknik i Lartë" me tre profile: Sisteme Kompjuterike; Sisteme Elektrike dhe Sisteme Motorike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 355, datë 28.06.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Është program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/15
18	Numri i studentëve:	176
19	Komente / të tjera:	



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile: sisteme kompjuterike, sisteme elektrike, sisteme motorike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” me 3 profile është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit, gjë e cila reflektohet në Statutin e KUB. Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” me 3 profile është në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit, Në shtojcën e strategjisë së planit strategjik të Institucionit 2015–2020 është e parashikuar hapja e programeve të studimit me karakter profesional, referenca Nr. 3 Plani Strategjik.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në nenet e Statutit të KUB nuk jepet informacion në lidhje me drejtimit prioritar akademike të tij, reference Nr. 2 Statuti. Në rregulloren e Institucionit, neni 54, pika 6 thuhet vetëm që KUB do të ofrojë dhe programi profesionale një ose dy vjeçare dhe në nenin 59 jepet pranimi në këto programe studimi.
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” ofrohet në përputhje më fushën akademike të njësisë kryesore, referencë neni 20 Rregullore KSLP, e cila mbështet vetëm programe studimi me karakter profesional. Departamenti i studimeve të larta teknike, DSLT, mbështet vetëm këtë program studimi me karakter profesional dhe është në përputhje me drejtimin akademik, referenca Nr.82, tabela plotësuese për RVB.
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të pergjithshme dhe të mirefilltë të tregut lokal. Në dokumentin Nr. 16 të paraqitur nga KUB jepen objektivat strategjike, çfarë synohet të arrihet për punësimin e studentëve, një studim të mbi gjendjen e tregut të punës në Shqipëri për profesionet si teknik i lartë në sistemet kompjuterike, sistemet elektrike, teknik i lartë në sistemet motorrike si dhe analiza SWOT për mbështetjen e këtij





	programi studimi me karakter profesional.			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Programi i studimit “Teknik i lartë” me tre profilet diplomon studentët e parë në vitin akademik 2019-2020. Në materialin e paraqitur nga KUB, Nr.17, jepet informacioni që zyra e studentit dhe këshillimit të karrierës ndjek ecurinë e studentëve të diplomuar. Në këtë material jepet informacion në lidhje me programet e tjera të studimit që mbështet KUB.			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Në materialin e vënë në sistem dhe gjatë vizitës në institucion nuk gjetëm dokumentacion, që të përfshijë komunikim zyrtar me punëdhënësit e fushës mbi kërkesat dhe nevojat e tyre, për secilin nga profilet e programit të studimit, por vetëm marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë. Në sistem dhe në faqen zyrtare të Institucionit KUB janë vendosur vetëm lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, me emra të kompanive dhe me vulën e institucionit KUB. Në system janë vendosur disa marreveshje bashkepunimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi me karakter profesional Teknik i lartë është hartuar, mbikëqyret në lidhje me mbarëvajtjen e tij nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL). DSLTL bashkëpunon me DSLA për lëndën Gjuhë e huaj dhe njësitë e tjera kryesore të KUB për lëndët sociologji dhe komunikim profesional, referenca Nr.14. Për lëndët profesionale të secilit profil ka personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Në rregulloren e njësisë kryesore KSLT jepet informacion në lidhje me organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë respektive. Analiza e punës dhe mbarëvajtja e programit të studimit realizohet nëpërmjet NJSBC, nëpërmjet pyetësoreve për pedagogët dhe studentët, referencat Nr. 40 dhe Nr.41.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve për këtë program studimi me karakter profesional KUB ka vendosur marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe



bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>brenda vendit si Universiteti Aleksandër Moisiu në Durrës, shkollën e mesme profesionale Gjergj Caco, në Tiranë, shkollën e mesme profesionale Arben Brozi në Shkodër duke ftuar personel akademik në mësimdhënie.</p> <p>KUB ka pasqyruar në referencën Nr. 32 dhe ne faqen zyrtare http://kub.edu.al/partneret/, listën e marrëveshjeve që ka me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës. Evidenca të marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh pwr praktikwn mwsimore janë ato të vendosura në system pas kërkesës së grupit të ekspertëve.</p>			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Programi i studimit me karakter profesional ka filluar në vitin akademik 2018-2019 dhe nuk ka nxjerrë akoma të diplomuarit e parë. Njësia bazë e ka patur të pamundur për këtë periudhë kaq të shkurtër kohe të hartoj raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Mbështetur në planin mësimor 2018-2019, referencë Nr. 14 Dosja e plotë e programit, për të tre profilet nuk ka patur lëndë të praktikës mësimore në vitin e parë. Lënda praktikë mësimore ka qënë përkatësisht në semestrin e parë dhe të dytë të vitit të dytë. Më ndryshimet që kanë pësuar plani mësimore në vitin 2019, praktika mesimore është shpërnadarë në vitin e parë dhe në vitin e dytë.</p>			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>Gjatë vizitës në Institucion ju kërkuat dokumentacioni i plotë i zhvillimit të praktikës, dhe KUB ka vendosur në system disa marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p> <p>Ne faqen e tij institucioni ka vendosur listën e marrëveshjeve zyrtare që ka më kompani brenda vendit por pa vënë një marrëveshje tip që të na jepte informacion në lidhje me detyrimet e secilës palë në marrëveshje.</p> <p>http://kub.edu.al/partneret/</p>			
Kriteri 5. Institucioni ndërmer iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” nuk ka nxjerrë akoma të diplomuarit e parë, pasi ka filluar në vitin akademik 2018-2019. Institucioni ka informacion dhe ndjek punësimin e studentëve nëpërmjet zyrës së studentëve dhe karrierës. KUB ka marrë informacion, që studentët e vitit të dytë, që ndjekin këtë program studimi, megjithëse akoma nuk janë diplomuar, ka të punësuar si teknikë në të tre profilet, referenca Nr. 29. Gjë e cila tregon se tregu ka nevojë për diploma profesionale si teknik i lartë veçanërisht në sistemet motorike, ku studentët janë të punësuar në servise makinash.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sisteme motorike është i organizuar me lëndë, të cilat janë të ndara në kredite, leksione, seminare, ushtrime dhe laboratore, në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe VKM 41 datë 24.01.2018, ”Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018”. Programi i studimit është i organizuar me kredite ECTS në përputhje me sistemin Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, referenca Nr.14.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sistemet motorike synon të pajisë studentët me aftësi dhe njohuri për tu bërë profesionistë të suksesshëm sipas karakteristikave të secilit profil, referencë Nr.7, neni 3 i Rregullores së programit të studimi.</p> <p>Nga planet mësimore të secilit profil vërehet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në profilin sisteme kompjuterike ka lëndë si: teknologji rrjetash, sisteme komunikimi, sisteme kompjuterike, sisteme ëireless, administrim ndërmarrjesh, web server. 2. Në profilin sisteme elektrike ka lëndë si: Hyrje në informatike, mikroekonomi, hyrje në elektronike, burimet e rinovueshme, transmetimi i energjise elektrike, sistemet elektrike në mjetet lëvizëse etj. 3. Në profilin sisteme motorike ka lëndë si: Hyrje në informatike, mikroekonomi, qarqe elektrike, makina hibrite, motorret me djegie të brendshme, sistemet e sigurisë dhe kondicionimit etj. <p>Të cilat synojnë përfitim të njohurive gjithëpërfshirëse teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi, në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sistemet motorike kanë lëndë të karakterit profesional praktik:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Profili sisteme kompjuterike: sisteme shfrytëzimi, arkitekturë kompjuteri, sisteme wireless, programim në web. 2. Profili sisteme elektrike: Makinat elektrike, teknika e sigurimit, material elektroteknike, matje, elektronika e fuqisë. Transmetimi i energjisë elektrike.



	<p>3. Profilin sisteme motorike: Diagnozot e automobil, shërbimi teknik, sistemet e sigurisë dhe kondicionimit, sistemi elektrik elektronik i mjeteve, sistemet e suspencionit dhe drejtimit.</p> <p>Theksojmë që i jemi referuar planeve mësimore të ndryshuara për vitin akademik 2019-2020, pasi ato janë planet aktuale në fuqi. Në ndryshim nga planet mësimore të 2018-2019 në planet e ndryshuara dhe të miratuara për 2019-2020 ka ndryshim emërtim lëndësh, heqje lëndësh dhe futje lëndësh të reja.</p> <p>Studentët e vitit të dytë, të tre profileve, nuk kanë zhvilluar praktikë mësimore në vitin e parë, e gjithë lënda e praktikës ka qënë e shpërndarë në vitin e dytë.</p> <p>Në planet mësimore të ndryshuara, Referencë aneksi 17, për vitin akademik 2019-2020 është bërë një shpërndarje më e mirë e lëndës së praktikës mësimore, 8 kredite në vitin e parë dhe 8 kredite në vitin e dytë.</p> <p>Në programin e studimit të profilit sisteme elektrike duhet të ishte e përfshirë lënda praktike kryesore për këtë profil ajo e instalimeve elektrike, e cila mungon.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile sisteme kompjuterike, sisteme elektrike dhe sistemet motorike ka lëndë, të cilat synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale si: komunikimi profesional, administrim ndërmarrje, mikroekonomi, e drejtë mjedisi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>KUB është institucion jopublik i arsimit të lartë. Në përputhje me nenin 20, të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duhet të jetë e përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera. Kolegji Universitar ka në përbërjen e tij së paku dy fakultete.</p> <p>KUB ka në strukturën e tij tre njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Ekonomisë 2. Fakulteti i Drejtësisë 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale <p>Neni 20, pika 5. Kolegji universitar ofron programe studimi në ciklin e parë dhe/ose të dytë të studimeve dhe programe studimi me karakter profesional.</p> <p>KUB ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë në fakultetet e Ekonomisë dhe të Drejtësisë.</p> <p>KUB ofron programe të karakterit profesional në njësinë kryesore, Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, KSLP.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë”, mbështet nga KSLT, si njësi kryesore, që mbështet këtë program studimi ka dy njësi bazë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Studimeve të Larta Administrative - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike <p>dhe ofron vetëm programe profesionale me 120 kredite që finalizohen me lëshimin përkatësisht të një diplome profesionale, në përputhje me nenin 21, pika 2 dhe 3 e Ligjit 80/2015.</p> <p>Departamenti i Studimeve të Larta Teknike ofron vetëm programin e studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” me tre profile, me 120 kredite, dy vite me kohë të plotë.</p> <p>Ky Departament ka në përbërjen e tij, referencë Nr. 24, tabelat plotësuese për RVB dhe referencë CV stafi, vërejmë si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti 2018-2019: 5 pedagogë efektiv (PAE), me grada/tituj: 1 Prof. Asc, 1 Dr dhe 3 Msc. dhe 11 pedagog me kontratë (PAK) me grada/tituj: 3 Dr., 8 Msc. - Viti 2019-2020: 5 pedagogë efektiv (PAE), me grada/tituj 1 Prof. Asc, 1 Dr dhe 3 Msc.; 15 pedagog me kontratë (PAK) me grada/tituj: 3 Dr., 12 Msc. dhe 2 laborantë, 1 me kualifikim MP dhe 1 me kualifikim Bachelor. <p>Personeli ndihmës akademik nuk mund të ngarkohet me mësimdhënie, sic është paraqitur në tabelat 4 tek referenca tabelat plotësuese për RVB. Ngarkesën mësimore të laboratorëve e mban personeli akademik. Personeli ndihmës akademik asiston në përgatitjen e laboratoreve dhe mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>Shënojmë që në faqen zyrtare web të Institucionit, DSTL ka 4 PAE dhe jo 5 sipas referencës Nr. 24. https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/kolegji-i-studimeve-tee-larta-profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE përbën 25% të stafit akademik të Departamentit ndërsa 75% përbëhet nga PAK. - PAE e DSTL së bashku me njësitë e tjera bazë të KUB, të cilët japin mësim janë në raport 10PAE/15PAK, 40%/60% - PAE mban ngarkesën si mëposhtë sipas profileve: <p>Sisteme motorike: 57% PAE dhe 43% PAK Sisteme elektrike: 24% PAE dhe 76% PAK Sistemet kompjuterike: 64% PAE dhe 36% PAK</p> <p>Kushti ligjor që stafi të mbajë 70% të ngarkesës nuk plotësohet për asnjë nga profilet.</p> <p>Në total shpërndarja e ngarkesës për programin e studimit me karakter profesional, referuar tabelës 12.1, tabelat plotësuese për RVB, duke marrë në llogaritje dhe praktikën profesionale është: 62.65% PAE dhe 37.35% PAK.</p> <p>Problemi kryesor me stafin, që kemi vënë re, tabela 8, referenca tabelat plotësuese për RVB, është se 3 (tre) nga PAE dhe 1 (një) personel ndihmës akademik janë në moshë pensioni. 2 (dy) PAE dhe 1 (një) personel ndihmës akademik nuk janë të punësuar në përputhje me neni 65, LAL 80/2015, Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik, neni 47 Statuti KUB dhe neni 48 i Rregullore KUB.</p>
--	--

	<p>Drejtuesi i Departamentit DSLP është në moshë pensioni, por në përputhje me neni 65, pika 2, LAL 80/2015 për nevoja të institucionit mund të shërbejë në detyrë, pasi ai zotëron titullin akademik Prof. Asc.. Nga stafi i DSTL mbeten vetëm 2 PAE që janë të punësuar në përputhje me LAL 80/2015 dhe Rregulloren e KUB.</p> <p>Numri i personelit akademik PAE është shumë i vogël në krahasim me PAK, pasi janë tre profile me shumëllojshmëri të madhe lëndësh teknike që i dallojnë qartësisht nga njëri tjetri.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Profili i sistemeve motorike: 5 janë PAE dhe 7 janë PAK. Duhet theksuar se nga PAE vetëm dy japin lëndë të profesionit, 3 PAE japin lëndë bazë, anglisht, mikroekonomi, e drejte mjedisi, komunikim profesional. - Profili sisteme elektrike: 5 janë PAE dhe 10 janë PAK. Duhet theksuar se nga PAE vetëm 2 japin lëndë të profesionit, 3 PAE japin lëndë bazë. - Profili sisteme kompjuterike: 7 janë PAE dhe 7 janë PAK. Duhet theksuar se nga 3 PAE japin lëndë të formimit bazë. <p>Ndërsa nisur nga punësimi jo i duhur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - profili sisteme elektrike nuk ka asnje PAE të profesionit, - profili sisteme motorike ka 1 (një) PAE të profesionit - profili sisteme kompjuterike ka 2 (dy) të profesionit. <p>Kualifikimi i personelit akademik PAE dhe PAK është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit 80/2015, i cili kërkon minimumi të kenë diplomën Master Profesional.</p> <p>Mbështetur në LAL 80/2015, neni 42, pika 3, drejtuesi e njësisë kryesore është personel akademik i kategorisë “Profesor”.</p> <p>Drejtuesi kryesor i KSLP nuk është personel akademik i kategorisë “Profesor”, ai mban vetëm gradën shkencore “Doktor”</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit “Teknik i lartë”, neni 3 jepet vetëm objektivi kryesor i këtij programi studimi që është të pajisë student me aftësi dhe njohuri për tu bërë profesionistë të suksesshëm sipas karakteristikave të secilit profil.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit duhet të ishin vendosur objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve për secilin profil, pasi ato janë shumë të ndryshëm nga njëri tjetri.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënësve, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Në rregulloren e këtij programi studimi me karakter profesional jepet informacion në lidhje me objektivin kryesor të programit të studimit me tre profile, organizimin e studimeve, kriteret e pranimit, format e regjistrimit, format e studimit, kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit nuk jepen fushat e mundshme të punësimit për asnjë profil, referencë Nr. 7 Rregullore e programit “Teknik i Lartë”.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë jepen rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p> <p>Programi i studimit ka filluar në vitin akademik 2018-2019 prandaj nuk ka akoma të diplomuarit e parë.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik I Lartë” me tre profile është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese, leksione, ushtrime, laboratore, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe përcaktimet evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” me tre profile, përmban planin mësimor, për secilin drejtim të miratuar nga MASR për vitin akademik 2018-2019, planin mësimor të ndryshuar për vitin akademik 2019-2020, për të tre profilet. Në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË” , pika 2.9 c, duke qënë se ndryshimet janë më pak se 20% për secilin profil, është njoftuar MASR me shkresën Nr. 173, datë 06.05.2020 pas miratimit të tyre nga Senati Akademik me Vendimin Nr.25, datë 13.03.2019.</p>

Në planet mësimore të miratuara në vitin akademik 2018-2019, me Vendimin Nr. 8, datë 29.03.2018 të Senatit akademik jepet informacion në lidhje me numrin total të krediteve për lëndë, orët gjithsej sipas leksioneve, Seminar+ushtrim + laborator.

Në Rregulloren e KUB ose të njësisë kryesore duhet të jepej tabela e ndarjes së krediteve në orë në auditor dhe individuale, në varësi të veprimtarisë, për shembull 1 krediti leksion sa orë mësimore i takojnë në auditor dhe punë individuale, 1 kredit ushtrime sa orë mësimore i takojnë në auditor dhe punë individuale e kështu me radhë për laboratorët etj.

Nga plani mësimor shohim që 1 krediti leksion i takojnë 10 orë mësimore por ka konfuzion për orët mësimore ushtrime dhe laboratore. Kur kemi 1 kredit ushtrime dhe laboratore është 15 orë dhe kur kemi 2 kredite ushtrime dhe laboratore është 23 orë mësimore në auditor, referencë tabela 10.

Në planin mësimor dhe ngarkesën mësimore javore për secilën lëndë, rezultojnë 21 orë mësimore. Kjo është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 pika 2.1 d, ku kërkohet që ngarkesa mësimore javore të jetë deri në 25 orë mësimore.

Në sistem janë vendosur planet mësimore të ndryshuara dhe të miratuara për të tre profilet, viti akademik 2019-2020, të miratuara me Vendimin i Senatit Akademik të KUB Nr. 34 datë 09.10.2019 pasi ato janë planet mësimore në fuqi, referencë shtojca Nr. 5.

Nga plani mësimor 2019-2020 për profilin sisteme elektrike konstatojmë: se lënda Materiale Elektroteknike zhvillohet dhe vitin I semestri I, me Nr5 dhe vitin e II, semestri parë, lënda me Nr.1. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me lëndën Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 2



4. Për sisteme motorike:

- lënda Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 5.
- Lëndët Anglisht III dhe Ndërtim shasie, të cilat janë hequr me ndryshimet në planet mësimore për vitin 2019-2020 kanë mbetur në planet mësimore të dërguara, referencë Vendimi Senatit Nr. 25 datë 13.3.2019.



5. Për sistemet kompjuterike:

- lënda Anglisht II gjendet dhe në vitin I, semestri II, Nr. 12 dhe vitin e II, semestri I, Nr. 5.
- Lëndët: Matje, Anglisht III dhe Anglisht IV të cilat janë hequr me ndryshimet në planet mësimore për vitin 2019-2020 kanë mbetur në planet mësimore të

	<p>dërguara, referencë Vendimi Senatit Nr. 25 datë 13.3.2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lënda Administrim ndërmarrje, për të cilën është dërguar syllabusi nuk gjendet në planin mësimor të vitit 2019-2020. <p>Informacioni mbi frekuentimi/ndjekjen e programit të studimit, vlerësimin e dijeve, aktivitetet specifike jepet në Rregulloren KLPS dhe të programit të studimit dhe syllabusin e çdo lënde dhe rregulloren e diplomimit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Syllabuset e secilët lëndë të paraqitur janë në përputhje të plotë dhe përmbajnë të gjitha elementët e përcaktuar nga VKM 41, datë 24.01.2018, shtojca Nr. 2 “Programi i lëndës”.</p> <p>Sqarojmë se për syllabuset janë parë ato të miratuara për planin mësimor të vitit akademik 2019-2020 pasi janë planet mësimore në fuqi.</p> <p>Syllabuset janë verifikuar mbështetur në referencën: Aneksi Nr. 19, pasi planet mësimore për vitin akademik 2019-2020, të miratuara me ndryshimet për secilin profil, Vendimi i Senatit akademik Nr. 34, datë 0.9.10.2020, janë në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në sistem vihet re se mungojnë syllabuset si mëposhtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Profili sisteme motorike: <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i transmetimit të fuqisë - Teknika e sigurimit - Histori civilizimi - Makinat hibride 2. Profili sisteme kompjuterike: <ul style="list-style-type: none"> - Bazat e të dhënave - Programim në ëeb - Teknikat e sigurimit teknik - Elektroteknikë - Teknologji informacioni 3. Profili sisteme elektrike: <ul style="list-style-type: none"> - Impiante elektrike - Makina elektrike - Elektronika e fuqisë - Hyrje në shkencat politike - Sistemet elektrike të mjeteve në lëvizje - Impjante industrial <p>Vlen të theksohet se si literaturë kryesore, në shumicën e</p>

	<p>lëndëve teknike, shërbejnë leksionet e shkruara të pedagogëve të lëndës. Ndërkohë duhet që të shfrytëzohen dhe literaturë në shqip pasi ka për lëndët teknike, te profileve.</p>
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile është fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në dy vite akademike, me 60 kredite secili vit. Në vitin e parë janë vendosur kryesisht lëndë të formimit bazë në të tre profilet si: Algjebër, Fizikë, Komunikim profesional, hyrje në informatikë, Administrim ndërmarrje. Me ndryshimet e miratuar për vitin akademik 2019-2020, në vitin e parë janë vendosur dhe 8 kredite praktikë profesionale, e cila ishte e gjitha në vitin e dytë me planet mësimore të miratuara për vitin akademik 2018-2019.</p> <p>Në vitin e dytë me planet mësimore të ndryshuara 2019-2020 është bërë një përshtatje më e mirë e titujve të lëndëve me përmbajtjen e tyre si dhe heqja e lëndëve me kredite të pajustificuara për programet e studimit profesionale English III dhe English IV dhe zëvendësimi i tyre me lëndët: Baza e të dhënave, Teknologji informacioni, Programim web dhe Teknikë sigurimi për profilin sisteme kompjuterike.</p> <p>Shtimi i lëndëve: Makina elektrike, Elektronika e fuqisë për profilin sisteme elektrike.</p> <p>Heqja e lëndëve English III dhe ndërtimi shasie për profilin sisteme motorike dhe futja e lëndëve Materiale dhe vizatim teknik, teknika e sigurimit teknik.</p> <p>Ne profilin sisteme elektrike do të ishte me vend që të ishin vendosur dhe lëndë si Instalimet elektrike ne mjedise civile dhe industrial, PLC, ndriçim elektrik dhe kontroll Automatik në vend të lëndëve të Automatizimit apo Transmetimi i energjisë elektrike.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” me tre profile në planin mësimor ka të shënuar ndarje në kredite (Seminare+Ushtrime)&laboratore por nuk e ka të përcaktuar qartë sa kredite i takojnë laboratorëve për të gjykuar qartë për vendin dhe peshën që u jepet punës konkrete praktike. Në planet mësimore për vitin akademik 2020-2021 duhet që njësia bazë përgjegjëse ti detajoj më mirë planet mësimore.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve të caktuara, që u përkasin lëndëve të profesionit janë të vendosura të ndara orët e ushtrimeve dhe të laboratoreve.</p> <p>Në disa syllabuse si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në Informatikë janë të ndara: 11 ore ushtrime 12 orë






	<p>laborator.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bazat e Mekanikës: 17 ore ushtrime dhe 6 ore laborator - Materialet elektroteknike: 11ore ushtrime, 12 orë laborator. - Sistemet wireless: 11ore ushtrime, 12 orë laborator. - Sistemet Linux: 7 ore ushtrime, 8 orë laborator. - Arkitekturë kompjuterash: 11ore ushtrime, 12 orë laborator. <p>Pra laboratorët apo pjesa praktike zë gjysmën e orëve ushtrime dhe laboratore, të vendosura në planin mësimor me 2 kredite.</p> <p>Në disa lëndë është vendosur detyrë kursi ndërkohë që nuk është e shprehur me kredite apo orë mësimore as në planin mësimor dhe as në syllabus, për shembull në lëndët: Normativa në punimet elektrike, Teknika e matjeve, Karburantet dhe sistemi i shkarkimit etj. Nëse jepet detyrë duhet të shprehet në planin mësimor me kredite, Udhëzimi 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e arsimit të lartë”, pika 4.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional ka 16 kredite në total praktikë mësimore, 13.33%, me planet e ndryshuara 8 kredite në vitin e parë, semestri i dytë dhe 8 kredite viti i II, semestri i dytë, gjë e cila ju lejon studentëve të merren me punë konkrete.</p> <p>Përsa i përket vlerësimit në syllabuset e paraqitura të të tre profileve nuk jepet ndonje informacion në lidhje me vlerësimin e studentëve për laboratorët e kryera. Për lëndën e praktikës mësimore ka një komision me tre pedagog, i ngritur nga Drejtori i KSLP për vlerësimin e relacioneve të studentëve që kanë kryer praktikën profesionale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		



Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Emërtimi i programit të studimit “Teknik i Lartë” është në përputhje me përcaktimin ligjor për programet profesionale në ligjin 80/2015. Shpërndarja në dy vite akademik dhe numri i krediteve 120 për këtë program studimi është në përputhje me ligjin 80/2015, neni 72, pika 1 për programet e studimit me karakter profesional.
	Vlerësimi në kredite dhe orë mësimore është në përputhje

	<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me tre profile ka për të tre profilet të njëjtë, me 30 kredite, semestrin e parë të vitit të parë, reference Nr. 14, Dosja e plote e programit të studimit. Semestrat e tjerë janë me lëndë që nuk janë në profilet e tjera me përjashtim të lëndëve bazë apo ndërdisiplinore.</p> <p>Mbështetur në VKM 41. Datë 24.01.2018, Pika 2.9 a) Programi i studimit mund të organizohet në profile, të cilat ofrojnë specializime në drejtime të ngushta të fushës së programit të studimit, në fusha integruese ose ndërdisiplinore të përafërta.</p> <p>Të tre profilet e këtij programi studimi me karakter profesional ofrojnë në fakt specializime në drejtime të gjera dhe të ndryshme të programit të studimit. Prandaj emërtimi i tyre në profile nuk përputhet me përcaktimin e mësipërm të VKM 41. Këto profile mund të konsiderohen programe studimi të veçanta pasi i përkasin fushave të ndryshme inxhinierike, si inxhinieria elektrike, inxhinieria mekanike dhe inxhinieria kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore i programit të studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë”, me tre profile mundëson arritjen e objektivave formues të profilit specifik, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Plani mësimor duhet të ishte i detajuar dhe të pasqyronte qartë ndarjen në kredite të ushtrimeve, laboratoreve dhe detyrës së kursit, mbështetur në Udhëzimin 29, datë 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, pika 4.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit, për vitin akademik 2020-2021 duhet që ti detajoj planet mësimore, në përputhje me udhëzimet në fuqi..</p> <p>Emërtimet e lëndëve janë përmirësuar në planet mësimore të ndryshuara për vitin akademik 2019-2020. Syllabuset e lëndëve i përmbajnë të gjitha elementët e kërkuara nga VKM 41 dhe janë informuese në lidhje me aktivitetet kryesore të tyre, leksione, ushtrime dhe laboratore.</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në</p>	<p>Mbështetur në planet mësimore të paraqitura, 2018-2020, referenca Nr. 14 Dosja e plote e programit, lëndët janë përgjithësisht 5 kredite me ndarje 3 kredite leksione, teori dhe 2 kredite (seminar/ushtrime+laborator), praktikë.</p>





<p>praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Raporti sipas krediteve qëndron 60% teori / 40% praktikë.</p> <p>Në orë mësimore janë 2 orë në javë teori dhe 1.5 orë në javë praktike. Pra raporti teori me praktikë për orë mësimore qëndron në raportet 57% teori/ 43% praktikë.</p> <p>VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “PËR MIRATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË”, Standarti II, Kriteri 4 përcakton “Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Kërkesë e njëjtë me VKM 879, datë 18.12.2019, shënimi poshtë Tabelës 1.1,</p> <p>Kërkesa tjetër e VKM 41 është që: Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p> <p>Në të tre profilet e programit të studimit 16 kredite i dedikohen Praktikës Profesionale që përbën 13.3% të programit.</p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Raporti midis formimit teorik dhe atij praktikë duhet të rritet në drejtim të atij praktik për të plotësuar kërkesën ligjore (50/50), që për këtë program studimi, në të tre profilet, raporti sipas krediteve qëndron 60% teori / 40% praktikë, anon më shumë nga formimi teorik për lëndët profesionale. Ndërsa nëse merrët në tërësi, duke përfshirë dhe lëndën e praktikës mësimore kemi 50.88% teori dhe 49.12% praktikë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxëniet dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit. Ai duhet të plotësohet me syllabuset, të cilat mungojnë për secilin profil dhe që janë dhënë më sipër. Në planin mësimor duhet të jepen të ndara veç kreditet e laboratorëve nga ushtrimet, si dhe të jepen kreditet e detyrës së kursit, siç janë dhënë më tej në syllabuset përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson</p>	<p>Lëndët e vendosura në planin mësimor për të tre profilet e këtij programi studimi me karakter profesional janë lëndë të</p>




<p>kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>përshtatshme për profilet përkatëse.</p> <p>Në profilin e sistemeve elektrike do të rekomandonim vendosjen e lëndëve praktike si Instalimet elektrike në ambjentet civile dhe industrial, PLC, ndriçimin elektrik, të cilat janë lëndë praktike dhe shërbejnë për aftësimin praktik më të mirë të studentëve dhe formimin e shprehive të pritshme nga punëdhënësi duke patur parasysh kërkesat e tregut të punës për këtë profesion.</p> <p>Materialet mësimore për lëndët e profesionit janë të përgatitur nga pedagogët e lëndës përkatëse, reference syllabuset.</p> <p>Gjithashtu literatura e dhënë në disa prej lëndëve profesionale nuk është e pesë viteve të fundit, referencë syllabuset.</p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë”, me tre profile është i shtrirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në lëndët bazë për të tre profilet në semestrin e parë të vitit të parë për të tre profilet, me 14 kredite, me 11.67% (10-15%, VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1), - Lëndët karakterizuese janë të shtrira në vitin e parë, SII dhe vitin e dytë me 57 kredite për secilin profil, me 47.5% (45-55%, VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1). - Lëndët ndërdisiplinore janë në vitin e parë kryesisht me 17 kredite, 14.16% (5-15%, VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1) - Lëndët plotësuese janë në vitin i I dhe II, me 26 kredite për secilin profil, 21.66%, (10-15%, VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1). - Detyrimi përmbyllës 6 kredite, 5 % (3-5%, VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1) <p>Sic shihet qartë DSLP duhet të rrisë numrin e lëndëve karakterizuese për secilin profil dhe të ulë numrin e lëndëve plotësuese.</p> <p>Metodat kryesore të mësimdhënies janë leksione, seminare, ushtrime, laboratore. Vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme, ku ndjekja dhe pjesmarrja aktive gjatë zhvillimit të lëndës ka 20 pikë, testimi në mes të semestrit i njohurive të marra 20 pikë dhe testimi përfundimtar 60 pikë, referencë syllabuset dhe Rregullorja e programit të studimit, neni 9 Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste</p>	<p>Në të tre profilet e programit të studimit me karakter profesional, lëndët bazë si komunikim profesional dhe ato ndërdisiplinore integruese si: Administrim ndërmarrje, Sociologji, Mikroekonomi mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si</p>

konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.			
<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në të tre profilet e programit të studimit me karakter profesional kanë lëndën e praktikës, në planet e ndryshuara 2019-2020, me 8 kredite në vitin e parë dhe 8 kredite në vitin e dytë, që ndihmojnë studentët në njohjen e ambjentëve konkrete të punës në profesionet përkatëse.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje me kompani vëndase, dhënë në Referencën Nr.34 dhe faqen zyrtare të KUB Marrëveshje bashkëpunimi aktive. Në fakt Institucioni apo njësia kryesore që mbështet programin e studimit duhet të vendosë në sistem një marrëveshje tip që ka me kompani vendase apo Institucion të Arsimit të lartë për gjykuar mbi detyrimet që kanë palët në bashkëpunim.</p> <p>Në syllabusin e praktikës profesionale për të tre profilet me urdhër të Drejtorit të KSLP ngrihet grupi i punës për vlerësimin e praktikës. Ndërkohë Drejtuesi i njësisë bazë përcakton pedagogët, të cilët do të ndjekin studentët në zhvillimin e praktikës. Kjo ngarkesë e pedagogëve PAE, të cilit ndjekin praktikën mësimore, duhet të shprehet si ngarkesë e tyre mësimore për lëndën e praktikës. Mungon në dokumentacionin e paraqitur, referencë Nr. 24.</p> <p>Ka një relacion të përgatitur nga studentët, i kërkuar gjatë vizitës në institucion, i cili është shumë i thatë dhe nuk të jep informacion se çfarë njohurish ka marrë student gjatë qëndrimit të tij 5 javor në praktikë. Vlerësimi i studentëve përcaktohet nga tre komponentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. vlerësimi i pedagogut që ndjek praktikën profesionale. 2. Pjesmarrja dhe aktivizimi i studentëve në kompani gjatë zhvillimit të praktikës. 3. Relacioni përfundimtar i praktikës i cili vlerësohet nga komisioni i vlerësimit, i ngritur me urdhër të Drejtorit të KSLP. <p>Këto komponentë janë të shënuar vetëm në dokumentacion pasi në paketën e praktikës, të kërkuar gjatë vizitës në Institucion dhe të vënë në sistem nuk ka një relacion të vlerësimit nga pedagogu që ndjek praktikën ndërsa relacioni përfundimtar i vënë në sistem është i paplotë, nuk jep asnjë informacion mbi njohuritë që ka mësuar apo zbatuar studenti në praktikë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikatat më të mira të fushës

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Institucioni KUB ka ngritur njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, NJSBC për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, e përbërë nga 7 anëtarë ku një prej tyre është student, referenca Nr.37.</p> <p>NJSBC ka detyra kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aprovimi, monitorimi dhe shqyrtimi periodik i programeve; - Vlerësimi i studentëve; - Sigurimi i cilësisë së stafit mësimdhënës; - Burimet e mësim nxënies dhe mbështetjes së studentëve; - Informimi i publikut. <p>KSLP dhe njësia bazë përgatitin dhe pyetësor për studentët në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, metodat e përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë studentët.</p> <p>Njësia bazë që mbështet programin e studimit përgatit raport në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, cilësinë e studentëve dhe rezultatet e arritura në provime për çdo lëndë.</p> <p>Raportin e NJSBC janë të publikuar në faqen e institucionit KUB. http://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/</p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, laboratorët, detyra e kursit, praktikatat profesionale mbështetur në dokumentacionin e vënë në sistem dhe nga takimet e realizuar me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 janë zhvilluar dhe leksionet dhe ushtrimet online duke shfrytëzuar platformën online google classroom, nëpërmjet portalit të vendosur në faqen zyrtare web te Institucionit, https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</p>






	Të gjitha këto forma janë të përshtatshme për të realizuar këtë program studimi me karakter profesional me tre profile, në kushtet e pandemisë.			
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Personeli akademik i këtij programi studimi përdor forma dhe mënyrat tradicionale të mësimdhënies nëpërmjet shpjegimit në tabelë, shpjegimit me powerpoint. Gjatë vizitës në institucion nga biseda me pedagogët dhe studentët na u tregua se një metodë efektive e mësimdhënies ishte ajo interactive pedagog student, që përdorej më shumë gjatë orëve të ushtrimeve apo të laboratoreve, sidomos në profilin e sistemeve kompjuterike. Për t'ju përgjigjur nevojave të mësimdhënies për shkak të situatës së Covid 19 mësimi në semestrin e dytë të vitit të dytë është zhvilluar plotësisht online në përgjigje të nevojave të studentëve. Kjo gjë është e pasqyruar dhe në faqen zyrtare Web e KUB http://kub.edu.al/leksione-online-kub/			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie si ai PAE dhe PAK ka kualifikimin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Ato janë kompetente në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit. Mbështetur në CV e vendosura në sistem, janë specialist të fushave përkatëse, por janë PAK, gjë e cila krijon pasiguri për këto programe studimi			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka nevojë urgjente rritjen e numrin të PAE për këtë program studimi pasi është i vogël krahasuar me atë PAK, për vitin akademik 2019-2020, 5 janë PAE dhe 15 PAK, ku 2 nga PAE nuk janë të punësuar në përputhje me LAL 80/2015 dhe Rregulloren e KU. Peshën kryesore për lëndët karakterizuese të profilit, sidomos në profilet e sistemeve motorike dhe sisteme elektrike e mbajnë personeli që vjen nga PAK dhe janë specialistë të fushave të tyre të eksperiencës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.

Nga vizita në Institucion dhe nga materiali i venë në system, Referenca Nr. 42, të dhëna mbi infrastrukturën vumë re se KSLP e zhvillonte mësimin në godinën B:

Në këtë godinë ka hapsira si mëposhtë:

1. Profili sisteme motorike ka një laborator të dedikuar ku zhvilloheshin të gjithë labororet për lëndët karakterizuese, viti I dhe Viti II, 17 studentë viti I dhe 26 studentë viti II
2. Profili sisteme elektrike ka një laborator të dedikuar ku zhvilloheshin të gjithë labororet për lëndët karakterizuese, viti I dhe Viti II, 31 studentë viti I dhe 19 studentë viti II
3. Profili sisteme kompjuterike ka një laborator kompjuterik të dedikuar, në katin e tretë, por mund të zhvillohet mësim dhe në laboratorët e tjerë informatik, viti I dhe Viti II, 29 studentë viti I dhe 19 studentë viti II

Në katin përdhe gjendeshin dy laboratorët e sistemeve motorike dhe elektrike dhe tre sallat e leksioneve, të cilat ishin të pajisura me, kompjuter, projektor dhe tabelë të bardhë. Sallat e leksioneve nuk kishin tavolina të mëdha por të vogla të lidhura me karrigen. Për mendimit tonë mungesa e tavolinave krijon vështërsi.

Në katin përdhe kishte dhe një ambient të dedikuar për të bërë fotokopje studentët.

Studentët mund të shfrytëzonin sallat e kompjuterit dhe në godinën A.

Në katin e parë ka 3 auditore leksionesh, dy salla personeli dhe tualete.

Në katin e dytë ka 3 auditore leksionesh, një sallë personeli dhe tualete.

Në katin e tretë ka 1 auditor leksionesh, një sallë laboratorit të informatikës, biblioteka, 3 salla personeli dhe tualete.


Numri i studentëve të regjistruar është 93 për vitin akademik 2018-2019 dhe 77 studentë për vitin akademik 2019-2020, referenca Nr. 27. 7 studentë janë çregjistruar e dhënë e marrë gjatë vizitës në Institucion.

Informacioni i dhënë nga KUB në tabelën 21, duhet saktësuar dhe të reflektojë dhe numrin e studentëve të çregjistruar.

Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin

Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike veçanërisht ato të profilit sisteme kompjuterike. Në laboratorin e informatikës ka

<p>mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>infrastrukturë të konsoliduar IT dhe softje profesionale. Institucioni KUB ka sistem për komunikim të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar nëpërmjet portalit të KUB https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</p>			
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë në shumicën e lëndëve karakterizuese janë leksione të pedagogëve të lëndës, që u vihen në dispozicion studentëve të printuara ose në formë elektronike. Në bibliotekën e KSLP ka një numër të caktuar librash të dhëna si referencë. Kjo bibliotekë duhet të pasurohet me libra të tjerë teknikë si në gjuhën shqipe ashtu dhe në atë të huaj.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion librari elektronike me kontratë si: Questia, Academia.edu dhe librari të tjera online free.</p>			
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line me kontratë si: Questia, Academia.edu dhe librari të tjera online free</p> <ul style="list-style-type: none"> • thefreelibrary.com • EBSCO • gutenberg.org • cobiss • readprint.com • ebrary 			
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për të tre profilet ka nga një laborator të dedikuar, të cilët duke patur parasysh numrin e studentëve dhe orët e laboratorit për secilën lëndë shfrytëzohen plotësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme.</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Të detyruar nga kushtet e pandemisë gjatë gjithë semestrit të dytë të vitin akademik 2019-2020, në funksion të mësimdhënies janë përdorur platformat online të google classroom dhe zoom për zhvillimin e leksioneve dhe ushtrimeve. Për këtë është shfrytëzuar portal i institucionit, me guidat përkatëse për stafin dhe studentët.</p> <p>https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi III.3



Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Struktura kryesore e institucionit, në nivel institucional, që ndjek, monitoron dhe vlerëson procesin e mësimdhënies është NJSBC. Gjatë vizitës në Institucion, në takimin e zhvilluar me NJSBC na u sqarua se kjo njësi në mënyrë periodike ushtron kontrollon lidhje me mësimdhënien, prezencën e studentëve në mësim, cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e syllabuseve dhe zbatimin e standarteve sipas kornizës ligjore në fuqi. Ky program studimi me karakter profesional mbështet vetëm nga njësia bazë DSLT.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia kryesore KSLP dhe njësia bazë DSLT janë përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë e programit të studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë”. Për monitorim e mësimdhënies në departamentin që mbështet këtë program studimi shërben Drejtori i KSLP, drejtuesi i njësisë bazë dhe sekretaria mësimore. Nëpërmjet analizës vjetore të ecurisë së procesit mësimor dalin problematikat që kanë shoqëruar procesin mësimor në këtë program studimi. Në referencën Nr. Raporti Drejtuesit Departamentit
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik të angazhuar në këtë program studimi kanë përgjegjësinë kryesore janë angazhuar për një mësimdhënie cilësore. Nuk mund të flitet në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale pasi ky program studimi diplomon studentët e parë në vitin akademik 2019-2020 si dhe stafi akademik është kryesisht PAK.
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Për këtë program të ri studimi me karakter profesional janë të angazhuar kryesisht specialistë të ftuar të fushave përkatëse, në vitin akademik 2019-2020, 5 janë PAE dhe 15 PAK dhe nuk pamë të kishte trajnime të personelit akademik në drejtim të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies. PAE janë staf me eksperiencë, si psh Prof. asc. A. Hajdari, me 40 vite eksperiencë, F. Strati mbi 35 vite experience, S. Caco mbi 40 vjet eksperiencë në

	profesion, por janë në moshë pensioni.			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik u adoptua shpejt me metodat e reja të mësimdhënies online gjatë semestrit të dytë, kjo e dhënë u deklarua nga drejtuesi i departamentit dhe pedagogët gjatë takimit të realizuar me to në institucion. Personeli akademik i punësuar në këtë program studimi, vepron në mënyrë përputhje me rregulloren e KSLP, neni 12.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			x	

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimin, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale nuk janë të përcaktuara në rregullore të posaçme. Studentët marrin informacion në lidhje me mënyrën e testimit dhe vlerësimin nga rregullorja e programit të studimit, neni 9 Vlerësimi i dijeve dhe instrumentat e vlerësimin. Rregullat për provimet, riprovimet dhe përmirësimin e notës janë në rregulloren e institucionit, Kreu XI, Rregullat e studimeve. Nga vizita në sekretarinë mësimore në Institucion u verifikua që sekretaria mësimore mban regjistër të studentëve të këtij programi studimi sipas formatit të aprovuar nga MASR, fletët e provimit dhe notat të hedhura në regjistër. Nuk kishte ditë të caktuar mbas provimit për të shqyrtuar rezultatet e marra, por provimin mund ta shikonin vetëm studentët të cilët kishin ankimim për rezultatin e marrë.
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive/dijeve është vlerësim i vazhdueshëm pasi 20 pikë studentët i marrin nga pjesëmarrja aktive gjatë orëve të mësimin, 20 pikë nga provimi i ndërmjetëm i semestrit dhe 60 pikë provimi përfundimtar.
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e	Pedagogu i lëndës informon studentët në fillim të lëndës në lidhje me syllabusin e lëndës, ku jepet informacion në lidhje

<p>testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>me metodologjinë e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve të parashikuara për lëndën përkatëse, kjo e dhënë u deklarua nga drejtues i departamentit dhe pedagogët gjatë takimit të realizuar me to në institucion.</p>			
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik duke zhvilluar provime me shkrim dhe provime me gojë, referencë syllabuset.</p> <p>Nga vizita në institucion nuk morëm ndonje informacion në lidhje me zhvillimin e provimeve në formë elektronike.</p>			
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për lëndët e zhvilluara në këtë program studimi me karakter profesional realizohet nga pedagogu i lëndës. Në rast ankimimi nga ana e studentit të vlerësimit, komisione provimit përbëhet nga dy pedagogë. Komisionet e praktikës mësimore dhe të provimit të formimit përbëhen nga 3 anëtarë.</p> <p>Studentët informohen me email për vlerësimin e provimit. Ky informacion është marrë në institucion gjatë takimit të zhvilluar me pedagogët.</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Në rregulloren e Institucionit KUB, neni 91, Shpallja e vlerësimit nuk jepen afate kohore mbi zgjatjen e vlerësimit.</p> <p>Neni 92 i rregullores së KUB garanton të drejtën e vënies në dijeni dhe ankimimit të studentit. Në të përcaktohet afati kohor 24 orë i ankimimit mbasi student është njohur me vlerësimin e tij.</p> <p>Studentët të cilët nuk janë dakort me vlerësimin e rishikuar paraqesin ankesën e tyre me shkrim Brenda 3 ditëve tek drejtuesi i njësisë kryesore.</p> <p>Në neni 94 të rregullores së KUB jepet procedura e përmirësimit të vlerësimit të lëndës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	



Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.	Në të tre profilet e programit të studimit me karakter profesional garantohej përfitimi i njohurive dhe aftësive profesionale, që mbështeten së pari nga infrastruktura dhe laboratorët e IAL në dispozicion të testimit dhe zhvillimit të aftësive të veçanta të studentëve, si dhe zhvillimi i praktikave profesionale pranë kompanive dhe bizneseve në fushës e interesit profesional.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Në të tre profilet e programit të studimit me karakter profesional ka lëndë si hyrje në informatikë, sociologji, mikroekonomi, administrim biznes të cilat japin njohuri të përshtatshme në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Të gjitha këto njohuri të marra ndihmojnë që studentët të komunikojnë në mënyrë profesionale, të bëjnë diskutime në grup dhe të realizojnë zgjidhjen e problematikave të caktuara që dalin në punën e përditshme.
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	Në këtë program studimi është në fokus kryesor aftësimi i kompetencave praktike të studentëve. Njohuritë e përfituara në auditor testohen dhe zhvillohen më tej jo vetëm në laboratorët e IAL por edhe gjatë praktikave profesionale efektive në punëdhënësit dhe aktorët e biznesit duke bërë të mundur përfitimin e aftësive dhe formimit praktik të studentëve. Personeli akademik i lëndëve kryesore të formimit profesional ka shërbyer si tutor dhe koordinator të praktikave profesionale të studentëve me kompanitë dhe bizneset. Programi studimit me karakter profesional është program i ri studimi, për këtë arsye nuk ka mobilitet të studentëve me institucionet bashkëpunuese si psh Universiteti Aleksandër Moisiu në Durrës. Institucioni nuk ka marrëveshje me Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është i vetmi IAL në Shqipëri, i cili mbulon plotësisht fushat inxhinierike të profileve të këtij programi studimi.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe	Në përfundim të çdo lënde, organizohet provimi, nga pedagogu i lëndës, i cili vlerëson, analizon dhe shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në syllabusin e lëndës. Në fakt komisioni i provimit duhet patjetër të jetë i përbërë nga dy anëtarë, pedagogu i lëndës dhe


<p>syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>një pëdagog i një fushe të përafërt.</p> <p>Ky program studimi është i ri, në vitin akademik 2019-2020 nxjerr të diplomuarit e parë, prandaj mendojmë që eksperiencia e krijuar në këto dy vite akademike do të ndihmojë në orientimin e studentëve për zbatimin në prokatikë të njohurive të përfutuara. Këtë e tregon më së miri dhe ndryshimi i planeve mësimore për vitin akademik 2019-2020, që në vitin e parë të zbatimit të këtij programi studimi me karakter profesional, përshtatja më e mirë e emërtimit të lëndëve me përmbajtjen, heqja e disa lëndëve dhe futja e disa lëndëve të tjera, rishpërndarja e praktikës në dy vitet akademike</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Diplomimi për këtë program studimi me karakter profesional realizohet me provim formimi. Procedurat për diplomimin e studentëve jepen në Udhëzimin e Drejtorit të KSLP “Për procedurat e kryerjes së provimit të diplomimit në programet e studimit profesionale në KSLP”.</p> <p>Në sekretarinë mësimore kishte regjistër zyrtar të studentëve, që ndjekin studimet në këtë program studimi por akoma të padiplomuar. Studentët e parë diplomohen në këtë vit akademik 2019-2020.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Për studentët e programit të studimit me karakter profesional “Teknik i lartë”, në të tre profilet zhvillohet provim formimi me shkrim dhe me gojë, ku provimi me shkrim ka 60 pikë nga 100 pikë. Provimi me gojë zhvillohet të paktën dy ditë mbas provimit me shkrim dhe vlerësohet me 40 pikë nga 100 pikë që ka provimi në total.</p> <p>Studentëve u jepet një listë me pyetje orientuese në lidhje me lëndët që do të jenë pjesë e provimit të formimit, pjesët teorike apo praktike që duhet të kenë në konsideratë studentët për tu përgatitur për këtë provim etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga IAL janë hartuar dhe zbatuar procedura për punësimin e personelit akademik në përputhje me aktet ligjore në fuqi, të percaktuara dhe në Rregulloren e KUB, neni 43 dhe 44, Rregulloren e KSLP, neni 11 dhe Rregulloren “Për marrëdhëniet e punës” duke specifikuar procedurat e ndjekura , kriteret të përgjithshme dhe të vecanta, të cilat publikohen dhe në faqen zyrtare web të IAL gjatë procedurës së rekrutimit.</p> <p>“5 Rregullore KUB”, “6. Rregullore KSLP” “Aneks 4 Per Marrëdhëniet e Punës” dhe “http://kub.edu.al/mundesi-punesimi-ne-kub/”.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga IAL janë mbledhur, regjistruar dhe përditësuar të dhënat e kërkuara të të gjithë kategorive të personelit të angazhuar në programin e studimit, për cdo semestër për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 dhe sipas profileve të programit të studimit.</p> <p>“20. CV stafit akademik te programit studimit”, “20. CV stafit akademik te programit studimit2” “23. Te dhenat tabelore per stafin akademik KSLP”, “Tabelat plotesuese per RVB” dhe “24. Te dhena t tabelore per personelin ne programin e studimit”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga IAL është dëshmuar angazhimi për rekrutimin e burimeve njerëzore të nevojshme dhe që përmbushin objektivat dhe kërkesat e programit të studimit, si dhe është krijuar mjedisi dhe kushte të përshtatshme dhe të barabarta për personelin e angazhuar që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale.</p>





mënyrë profesionale.	“Tabelat plotesuese per RVB”, “24. Te dhenat tabelore per personelin ne programin e studimit” dhe “42 te dhena per infrastrukturen”.			
Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga IAL është dëshmuar angazhim për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të personelit në IAL dhe fakultet, më së shumti, por dhe në programin e studimit, ku personeli ka përfituar nëpërmjet praktikave dhe shkëmbimit të eksperiencave me partnerët dhe leksionet e hapura. Vlen të theksohet mbështetja dhe kualifikimi për personelin e programit të studimit në metodat inovative të mësimdhënies dhe në platformat online të zhvillimit të mësimin në periudhën e pandemisë. “Tabelat plotesuese per RVB”, “43 te dhena per kualifikimin dhe kerkimin shkencor”, “46 Udhzues për përdorimin e teknologjise se Informacionit”, “ http://kub.edu.al/partneret/ ”, http://kub.edu.al/erasmus/?lang=en , “39 Udhzues per perdorimin e struktures se T.Informacionit ne KUB”			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				x

Standardi IV.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar dhe vënë në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor teorik, kryesisht në Godinën B, sipas numrit dhe grupeve mësimore të studentëve, si dhe natyrës specifike të moduleve të vecanta të programit të studimit. Godina B, një ndërtesë 4 katëshe ka në dispozicion të programit të studimit 4 salla leksionesh me një sipërfaqe prej 267 m ² dhe 4 salla seminaresh me një sipërfaqe prej 196 m ² , me një ambient dhe infrastrukturë të përshtatshme për procesin mësimor teorik të programit të studimit. “42 te dhena per infrastrukturen”, “Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, si dhe “ http://kub.edu.al/mjediset/ ”

Spalun

[Signature]

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se se mjediset mësimore në IAL si klasat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme për procesin mësimor, si laptop, projektor, si dhe akses në rrjetin Ëi-Fi.</p> <p>Në IAL janë në dispozicion të procesit mësimor mjediset dhe mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme të teknologjisë së Informacionit 2 laboratore informatike (1 laborator në Godinën A dhe 1 laborator në Godinën B), me një kapacitet prej 26 postesh PC të lidhura në rrjet, si dhe pajisje të tjera të infrastrukturës TIK secili. Këto laboratorë janë në dispozicion të procesit mësimor dhe praktikës të studentëve, si dhe kërkimit shkencor të stafit akademik. Laboratori i informatikës është i pajisur dhe me një dërrasë elektronike.</p> <p>“42 te dhena per infrastrukturen”, “Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, si dhe “http://kub.edu.al/labororet/”</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në Godinën B të IAL janë 3 laboratorë të dedikuar për tre profilet e programit të studimit përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratori i sistemeve Elektrike • Laboratori i sistemeve Mekanike • Laboratori i sistemeve kompjuterike, i Informatikës <p>Të cilët janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme si stenda, aparatura, pajisje dhe programe të nevojshme në laboratorin informatikës për programin mësimor gjatë zhvillimit të laboratorëve dhe praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit.</p> <p>“42 te dhena per infrastrukturen”, “Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, si dhe “http://kub.edu.al/labororet/”</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të programit të studimit 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me programe profesionale kryesisht open source si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cisco Packet Tracer 2. Arduino IDE 3. My SQL 4. C++ online Editor 5. Java online Editor <p>si dhe programe të tjera gjatë zhvillimit të lëndëve specifike të programit të studimit.</p>

	"42 te dhena per infrastrukturen", "Aneks 27", "Tabelat plotesuese per RVB", si dhe "http://kub.edu.al/laboratoreti/"			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka garantuar që përveç 3 laboratorëve sipas 3 profileve të programit të studimit në dispozicion për pjesën e praktikës profesionale të vitit të parë dhe mjedise të tjera profesionale nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikat profesionale me servise, kompani e biznese private. KUB ka nënshkruar 75 marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale dhe ka listuar si më të zgjedhurat dhe eficientet për praktikat profesionale të 3 profileve të programit të studimit, 12 biznese e kompani. "32. Tabele permbledhese me inst bashkepunuese", "34. Marreveshja bashkepunimi Aktive" "42 te dhena per infrastrukturen", si dhe "Aneks 27"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion falas dhe me kushte për akses të barabartë, bibliotekën mësimore, me sipërfaqe 70 m ² , në mjediset e Godines A për studentët (ku përfshihen dhe studentët e programit të studimit), personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për pjesën tjetër të personelit të IAL. Kjo bibliotekë mësimore është e pajisur me një sistem që administron fondin në dispozicion dhe informacionin e nevojshëm për të cilin ka një udhëzues të përgatitur. Përveç ambienteve të leximit në bibliotekën mësimore me kapacitet rreth 60 vende, në sallën e bibliotekës ndodhen 4 laptose për akses online të literaturës në dispozicion, si dhe janë është në dispozicion të studentëve për tu përdorur si sallë leximi, edhe salla e laboratorit të informatikës me 26 poste. Shërbimi i bibliotekës është nga ora 08:30 - 20:00. Ndërkohë në Godinën B, gjatë vitit akademik 2019-2020 është vënë në funksion një bibliotekë mësimore e dedikuar për dy programet e studimeve profesionale në një mjedis prej 47 m ² , që është mundësuar me



Spolu

[Signature]

	<p>donacione dhe me fonde të IAL.</p> <p>“Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, “39 Udhezues per perdorimin e struktures se T.Informacionit ne KUB”, “42 te dhena per infrastrukturen”, “45 Lista e teksteve ne biblioteke”, si dhe “http://kub.edu.al/biblioteka/”</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL, në bibliotekën mësimore të Godinës A, disponon nje fond mbi 5200 tekstesh për të gjithë studentët e IAL, në shqip dhe në gjuhë të huaj. Ky fond pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me fonde të IAL dhe donacione të herëpashershme. Biblioteka e re e iniciuar në Godinën B është e dedikuar për dy programet e studimit profesional, aktualisht ka në fondin e saj një numër modest prej 28 tekstesh për profilet e programit të studimit. GVJ konstaton se fondi ekzistues, në Bibliotekën mësimore të programit të studimit është i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye IAL duhet të sigurojë fondin e nevojshëm të teksteve të profileve të programit të studimit.</p> <p>“Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, “39 Udhezues per perdorimin e struktures se T.Informacionit ne KUB”, “42 te dhena per infrastrukturen”, “45 Lista e teksteve ne biblioteke”, si dhe “http://kub.edu.al/biblioteka/”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL, ka vënë në dispozicion falas dhe me kushte për akses të barabartë, bibliotekën mësimore dhe bibliotekat online, për të cilat institucioni ka bërë abonim një vjegar, përkatësisht për programet profesionale të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • https://www.academia.edu/ ku kane akses studentet e KSLP. <p>si dhe në disa platforma/biblioteka online falas si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • http://www.gutenberg.org/, • www.ebsco.com; • https://al.cobiss.net/ • www.readprint.com • https://www.thefreelibrary.com/ • http://www.ebrary.com/coip/ • https://www.dlib.si/?&language=enghttps://www.acm.org/ <p>Gjatë zhvillimit të mësimin online në semestrin e dytë, u vu në përdorim platforma Google, jo vetëm si platformë e mësimin online por edhe si bibliotekë online për aksesim të materialeve nga studentët nëpërmjet portalit të IAL. Biblioteka e re e iniciuar në Godinën B është e dedikuar për dy programet e studimit profesional, aktualisht ka në fondin e saj një numër modest prej 28 tekstesh për profilet e programit të studimit.</p>

	<p>GVJ konstaton se IAL duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës së programit të studimit, si dhe të përditësojë fondin ekzistues fizik të teksteve dhe abonimin në bibliotekën online në mbështetje të programit të studimit.</p> <p>“Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “Aneks 27”, “Tabelat plotesuese per RVB”, “42 te dhena per infrastrukturen”, “45 Lista e teksteve ne biblioteke”, “https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/” “39 Udhezues per perdorimin e struktures se T.Informacionit ne KUB”, si dhe http://kub.edu.al/biblioteka/.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar dhe vënë në dispozicion për realizimin e programit mësimor 3 laboratorë sipas 3 profileve të programit të studimit kryesisht për pjesën e praktikës profesionale të vitit të parë. IAL ka nënshkruar 75 marrëveshje bashkëpunimi me servise, kompani e biznese private për të lehtësuar dhe garantuar zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, në mjedise profesionale dhe me burimet e logjistikën e nevojshme sipas profilit të programit të studimit dhe në ndihmë të formimit profesional të studentëve.</p> <p>“32. Tabele permbledhese me inst bashkepunuese”, “34. Marreveshja bashkepunimi Aktive” “42 te dhena per infrastrukturen”, si dhe “Aneks 27”.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka parashikuar në raportet financiare sipas departamenteve dhe në mënyrë specifike për KLPS, të dhënat e planit të financimit të programit të studimit, buxhetin (shpenzime dhe të ardhura) të përvitshme, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe të një cikli të plotë të programit të studimit.</p> <p>“Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019” dhe “50 Te dhenat nga plani i financimit nga programi i studimit”</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në raportin financiar (tabelat e plan buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020) ka paraqitur dhe koston e planifikuar për programin e studimit për një vit dhe për ciklin e plotë të studimit. Të ardhurat kanë burim kryesor financimi tarifën e shkollimit dhe janë shpenzuar për mbulimin e të gjitha shërbimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative për zhvillimin e programit dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen të këtij programi studimi. Të ardhurat janë shpenzuar kryesisht për pagat e personelit dhe shpenzimet operative (qira e objekteve, mirëmbajtje dhe shërbime), si dhe një pjesë e vogël</p>






programit të studimit e në vijim.	<p>janë për shpenzime të tjera, ku presupozohet që janë përfshirë dhe shpenzimet për fondet e librave të rinj të bibliotekës mësimore dhe kontratat e abonimeve në bibliotekat ndërkombëtare.</p> <p>GVJ konstaton që KUB duhet të gjejë mbështetjen financiare të nevojshme për të financuar plotësimin dhe përditësimin e bibliotekës mësimore të përshtashme dhe të plotë, në funksion të programit të studimit.</p> <p>“Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019” ,“49 te dhenat mbi raportin financiar” dhe “50 Te dhenat nga plani i financimit nga programi i studimit”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4



Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep informacion të plotë e të hollësishtëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimin e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar, zbaton dhe bën publike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore, procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve, përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit të studentëve, në të cilat garantohet barazia dhe të drejta të njëjta për kandidatët dhe studentët e IAL.</p> <p>IAL ka publikuar në përputhje me politikat e marketingut të IAL, në faqen Web të saj, përvec rregulloreve të cituara më sipër, dhe Guidën studentore, një informacion i përmbledhur dhe shumë i vlefshëm për të gjithë studentët, që nga rregullat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit deri në diplomimin e tyre.</p> <p>“5. Rregullore KUB, nenet 56-60”, “6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit të studimit Teknik i Lartë, nenet 4-11”, “10. Rregullore Diplomimi”, “Aneks 26 Procedura e diplomimit ne KUB”, http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf “51 Politikat e marketingut”</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL, përpara cdo vit akademik, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të IAL harton dhe publikon kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve në të gjitha programet e studimit. Këto kritere publikohen në faqen Web të KUB, si dhe u</p>

<p>publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>bëhen të njohur kandidatëve dhe familjarëve të tyre nëpërmjet mjeteve të parashikuara në politikat e marketingut, si fletëpalosje, pjesëmarrjes në panairë për promovimin e karrierës, takimet me maturantët në kuadër të këshillimit të karrierës në ZA e rretheve, takime me maturantë dhe familjarë të tyre që vizitojnë KUB, spote televizive, mediat e shkruar dhe elektronike, rrjete sociale etj. IAL ka publikuar në faqen e internetit kriteret e pranimit të studentëve dhe regjistrimit në programet e studimit. Në studimet e larta profesionale nuk ka kriteret pranimi.</p> <p>“5. Rregullore KUB, nenet 56-60”, “6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit të studimit Teknik i Lartë, nenet 4-11”, “51 Politikat e marketingut”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut”, “http://kub.edu.al/kendi-i-maturantit/”</p> <p>Dhe”http://kub.edu.al/akademia/#1576583099508-c9c9f419-a4df”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të tyre, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve, si dhe diplomimit. Ky është një proces i vazhdueshëm informimi dhe këshillimi në IAL, që fillon me këshillimin e karrierës së maturantëve, në cdo aktivitet të organizuar nga KUB, në komunikimin në media dhe rrjetat sociale, nga personeli jepet informacioni i plotë mbi përparimin akademik, zhvillimin e procesit mësimor, praktikat profesionale kryesisht pranë institucioneve bashkëpunuese, vlerësimin e dijeve dhe deri në diplomimin e tyre. IAL ka publikuar Guidën studentore, një informacioni i përmbledhur dhe shumë i vlefshëm për të gjithë studentët, që nga rregullat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit, regjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>“51 Politikat e marketingut”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut”, “10. Rregullore Diplomimi”, “Aneks 26 Procedura e diplomimit ne KUB”,</p> <p>“http://kub.edu.al/kendi-i-maturantit/”,</p> <p>”http://kub.edu.al/akademia/#1576583099508-c9c9f419-a4df” dhe http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”</p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, si dhe orientimin dhe mbështetjen e studentëve në tregun e punës dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit. Procesi</p>

	<p>i informimit fillon me nisjen e studimeve ku nga personeli përgjegjës i KUB dhe KLPS bëhet një prezantim i hollësishëm i IAL dhe në mënyrë specifike mbi programin e studimit “Teknik i lartë”, me tre profile. Ky informim vijon përgjatë 2 viteve akademike për të gjithë elementët e programit të studimit. Nga IAL jepet mbështetja dhe këshillimi për mundësitë e punësimit, si dhe orientimin në tregun e punës. Gjatë leksioneve të hapura dhe vizitave në kompani të specializuara studentët informohen mbi aftësitë specifike të kërkuara nga tregu i punës.</p> <p>“51 Politikat e marketingut”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut” dhe http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka informuar dhe vënë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Për të informuar studentët afishohet informacioni i përmbledhur i strukturës mësimore i cili përmban periudhat e mësimit në auditor, sezonet e provimeve, periudha e praktikës profesionale. Në javën e parë të mësimit në secilën lëndë bëhet prezantimi i detajuar i lëndës, përmbajtja dhe veprimtaritë formuese të parashikuara. Me këtë informacion studentët njihen dhe në faqen Eëb të IAL, broshurave informuese (Guida studentore) dhe syllabuset e lëndëve. Ky informacion i përditësuar dhe i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën dhe veprimtaritë e ndyshme të parashikuara në programin e studimit publikohet në faqen Eëb të KUB.</p> <p>“Aneks 7 Struktura akademike 2018-2019 dhe 2019-2020”, “http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”, “http://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/#” dhe http://kub.edu.al/mjediset/.</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL,</p> <p>GVJ konstaton se informacioni rreth programit të studimit është i disponueshëm në faqen web të KUB dhe mund të aksesohet nga studentët në cdo kohë, lehtësisht dhe në distancë. Ndërkohë ky informacion mund të gjendet dhe në drejtorinë e KLPS, departmentin e DSLT, si dhe pranë sekretarisë mësimore.</p> <p>“Aneks 7 Struktura akademike 2018-2019 dhe 2019-2020”, “http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”.</p>

	Studentore-2019-2020.pdf”, “http://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/#” dhe http://kub.edu.al /mjediset/.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistem të brendshëm nëpërmjet të cilit të menaxhohet informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, në programin e studimit “Teknik i lartë”, me 3 profile. Ky informacion përpunohet nga personeli përgjegjës, pjesë e procedurës dhe regjistrohet dhe administrohet nga sekretaria mësimore sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse nga regjistrimi deri në diplomimin e studentëve. Nga ana e sekretarisë mësimore përpunohen dhe përgatiten raportet e kërkuara. “Aneks 28 Dosja e nje studenti në Sekretarinë Mësimore” dhe “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistem të brendshëm nëpërmjet të cilit administrohet informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ky informacion përpunohet dhe administrohet nga personeli përgjegjës i burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Nga burimet njerëzore dhe sekretaria mësimore përpunohen dhe përgatiten raportet e kërkuara. “Dosjet e personelit të DSLA në Zyrën e Burimeve Njerëzore”, “Aneks 28 Dosja e nje studenti në Sekretarinë Mësimore” dhe “Tabelat plotësuese per RVB”.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe

<p>siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistem të brendshëm që administrohet nga zyra e burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore që përpunon dhe përgatit dhe vë në dispozicion të personelit dhe studentëve të programit të studimit informacionin e kërkuar.</p> <p>“Dosjet e personelit të DSLA në Zyrën e Burimeve Njerëzore” dhe “Tabelat plotesuese per RVB”.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka në përdorim një platformë dhe module të vecanta që mundësojnë komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 janë zhvilluar dhe leksionet dhe ushtrimet online duke shfrytëzuar platformën online google classroom, nëpërmjet portalit të vendosur në faqen Eeb të IAL. Nëpërmjet integritit të portalit të IAL me modulet specifike të platformës google ofrohen shërbimet për komunikim të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar për personelin dhe studentët e IAL.</p> <p>“https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/” .</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistem që monitoron në kohë reale aktivitetin akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Ky informacion përpunohet dhe administrohet nga zyra e burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore që përpunojnë dhe përgatisin informacionin e kërkuar për organet drejtuese dhe titullarët e IAL.</p> <p>“Dosjet e personelit të DSLA në Zyrën e Burimeve Njerëzore”, “Aneks 28 Dosja e nje studenti në Sekretarinë Mësimore” dhe “Tabelat plotesuese per RVB”.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka në funksion platformën e faqes web, një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar azhurnohet në mënyrë të vazhduar dhe</p>

	në dy gjuhë.(gjuha shqipe dhe angleze). “http://kub.edu.al/”			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni në Statutin, neni 61 dhe Rregulloren e tij, neni 56 nuk ka hartuar procedura për pranimin në programet me karakter profesional. Vetëm në rregulloren e KSLP, neni 21, procedurat e pranimit në të gjitha programet e studimit shkruhet zbaton procedurat por nuk jepet asnjë shpjegim, cilat janë këto procedura. Në të gjitha dokumentat e vëna në sistem, Statuti dhe Rregullore e KUB, rregulloren e KSLP nuk jepet informacion në lidhje me kritëret e pranimit për këtë program studimi. Ky informacion jepet në rregulloren e programit të studimit por duhet të jepej më i plotë. Në rregulloren e programit të studimit, neni 5 jepet si kriter bazë përfundimi me sukses i ciklit të arsimit të mesëm të lartë si dhe në bazë të kriterëve të LAL 80/2015.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Informacion në lidhje me transferimin e studimeve, programet e dyta të studimit, rifillimin dhe pezullimin e studimeve jepen në Rregulloren e KUB. Studentët në këtë program studimi regjistrohen nëpërmjet u-albania. Në rregulloren e programit të studimit, neni 5, pika 3 shkruhet që kriteret shtesë për pranimin në programin e studimeve të larta profesionale miratohen dhe shpallen çdo vit nga KUB. Në materialet e vëna në dispozicionin nuk i kemi hasur këto kriteret shtesë. Kriteret të caktuara për këtë program studimi nuk ka pasi niveli i

	<p>studentëve që janë pranuar në këtë program studimi është i ulët, 5.5 për vitin akademik 2018-2019 dhe 5.9 për vitin akademik 2019-2020.</p> <p>Renditja e kandidatëve bëhet sipas mesatares së ponderuar të tyre, e cila siguron barazi dhe të drejta të njëjta për studentët e programit të studimit.</p> <p><u>http://kub.edu.al/wp-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf</u></p> <p>http://kub.edu.al/kendi-i-maturantit/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUB, nuk ka kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë program studimi. Në faqen web të KUB publikohen informacion në lidhje me këtë program studimi dhe çfarë ofron por nuk jepen kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Ky informacion në lidhje me programin e studimit realizohet me anë të fletëpalosje, pjesëmarrjes në panairë për promovimin e karrierës, takimet me maturantët në kuadër të këshillimit të karrierës në ZA e rretheve, takime me maturantë dhe familjarë të tyre që vizitojnë KUB, rrjete sociale etj. Në studimet e larta profesionale nuk ka kritere pranimit të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve por të përgjithshme, të vendosura nga ligji 80/2015 për studimet me karakter profesional..</p> <p>“5. Rregullore KUB, nenet 56-60”, “6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit të studimit Teknik i Lartë”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut”, “http://kub.edu.al/kendi-i-maturantit/”</p> <p>Dhe”http://kub.edu.al/akademia/#1576583099508-c9c9f419-a4df”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe pas vizitës, GVJ konstaton se KUB ka përcaktuar në Rregulloren KUB, Rregulloren e KSLP dhe Rregulloren e ekuivalentimit të studimeve informacion mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit “Teknik i Lartë”, me 3 profile ka informuar studentët në lidhje me provimet, kontrolli i dijeve dhe vlerësimin e dijeve, neni 8 dhe neni 9. Në lidhje me vlerësimin e aftësive të studentëve dhe diplomimit e tyre për këtë program studimi, KUB ka miratuar dhe zbaton një udhëzim për procedurat e diplomimit në studimet e larta</p>




	<p>profesionale, e cila organizohet si provim diplomimi për studentët e programit të studimit “Teknik i Lartë”, me tre profile organizohet në formën e provimit me shkrim(60 pikë) dhe me gojë(40 pikë).</p> <p>Gjithashtu studentët informohen në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës nga pedagogu.</p> <p>“6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit të studimit Teknik i Lartë”, “10. Rregullore Diplomimi”, “Aneks 26 Procedura e diplomimit ne KUB”.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në KUB, GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike institucioni publikon informacionin mbi programet e studimit, në faqen web të IAL, nëpërmjet fushatave të vazhdueshme të publicitetit, botimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese(Guida studentore) dhe informacionit gjatë vizitave të të interesuarve në institucion. Informacioni mbi programin e studimit u bëhet i ditur kandidatëve edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë për promovimin e karrierës, takimet me maturantët në kuadër të këshillimit të karrierës në ZA, mediat e shkruar dhe elektronike, rrjete sociale etj.</p> <p>“51 Politikat e marketingut”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut”,</p> <p>”http://kub.edu.al/akademia/#1576583099508-c9c9f419-a4df” dhe http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”</p> <p>”http://kub.edu.al/akademia/#1576583097649-4941ebe1-84b1”</p> <p>”http://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/”</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për</p>

Spalun

[Signature]

<p>studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, “Teknik i Lartë”, me 3 profile si dhe për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtarisë formuese. Procesi i informimit fillon me nisjen e studimeve ku nga personeli përgjegjës i KUB dhe KLPS bëhet një prezantim i hollësishëm i IAL dhe në mënyrë specifike mbi programin e studimit “Teknik i lartë”, me tre profile. Ky informim vijon përgjatë 2 viteve akademike për të gjithë elementët e programit të studimit. Nga IAL jepet mbështetja dhe këshillimi për mundësitë e punësimit, si dhe orientimin në tregun e punës. Gjatë leksioneve të hapura dhe vizitave në kompani të specializuara studentët informohen mbi aftësitë specifike të kërkuara nga tregu i punës. Me këtë informacion studentët njihen dhe në faqen zyrtare të informacionit, broshurave informuese (Guida studentore) dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>“51 Politikat e marketingut”, “Aneksi 12 Politikat e Marketingut”, “6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit të studimit Teknik i Lartë”, “10. Rregullore Diplomimi”.</p> <p>http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf.”</p> <p>”http://kub.edu.al/akademia/#1576583099508-c9c9f419-a4df”</p> <p>”http://kub.edu.al/akademia/#1576583097649-4941ebe1-84b1”</p> <p>”http://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/”</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni informon mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Ky informacion ndahet në faqen web të institucionit, në takimet me kandidatët dhe maturanët, gjatë javës së parë të orientimit nga departamenti. IAL informon studentët se ka vënë në dispozicion për realizimin e programit mësimor 3 laboratorë sipas 3 profileve të programit të studimit kryesisht për pjesën e praktikës profesionale të vitit të parë. IAL ka nënshkruar 75 marrëveshje bashkëpunimi me servise, kompani e biznese private për të lehtësuar dhe garantuar zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, në mjedise profesionale dhe me burimet e logjistikën e nevojshme sipas profilit të programit të studimit dhe në ndihmë të formimit profesional të studentëve. Në disa raste janë këto biznese që rekrutojnë studentët gjatë zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p>“7. Rregullore e programit Teknik i Larte”, “32. Tabele permbledhese me inst bashkepunuese”, “34. Marreveshja</p>

	<p>bashkepunimi Aktive” “42 te dhena per infrastrukturen”, si dhe “Aneks 27”.</p> <p>“http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”</p> <p>“http://kub.edu.al/partneret/”</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit “Teknik i Lartë”, me 3 profile. Që në javën e parë të orientimit studentët informohen nga departamenti mbi zhvillimin dhe organizimin e programit mësimor, logjistikës, infrastrukturën e programit të studimit. Gjithashtu studentët informohen në javën e parë të mësimit, gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës nga pedagogu. Informacioni i gjerë dhe i përditësuar gjendet dhe në faqen web të IAL.</p> <p>“7. Rregullore e programit Teknik i Lartë”, “Aneks 7 Struktura akademike 2018-2019 dhe 2019-2020”, “Aneks 14 Orari Mesimor 2018-2019 dhe 2019-2020”</p> <p>http://kub.edu.al/wp-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”</p> <p>“http://kub.edu.al/partneret/”</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Informacioni mbi programin e studimit “Teknik i lartë”, me 3 profile është lehtësisht i aksesueshëm nga çdo student i këtij programi në faqen web të IAL. Nëpërmjet portalit të IAL dhe moduleve të platformës Google të integruara me portalin kanë mundësi të aksesojnë materialet e lëndëve në të cilat janë regjistruar si dhe ndërveprojnë me stafin pedagogjik për çdo paqartësi. Kjo platformë aksesohet lehtësisht dhe në distancë nga studentët.</p> <p>“39 Udhezues per perdorimin e struktures se T.Informacionit ne KUB”, “46 Udhezues per perdorimin e teknologjise se Informacionit”</p> <p>“http://kub.edu.al/ep-content/uploads/2014/01/Guida-Studentore-2019-2020.pdf”</p> <p>http://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/</p> <p>https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/kolegji-i-studimeve-tee-larta-profesionale</p>

Spalun

[Signature]



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen manualisht të dhëna vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit “Teknik i Lartë”, me 3 profile.</p> <p>Në këtë program studimi janë regjistruar për vitin 2018-2019, 93 studentë në total dhe sipas profileve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ “Sisteme Elektrike” 39 studentë, ▪ “Sisteme Kompjuterike” 26 studentë, ▪ “Sisteme Motorike” 28 studentë, <p>Në këtë program studimi janë regjistruar për vitin 2019-2020, 77 studentë në total.</p> <p>“27. Te dhena tabelore per regjistrimin ecurine” dhe “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”.</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se siç u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore që regjistrohen manualisht për studentët e regjistruar në programin e studimit “Teknik i Lartë”, me 3 profile. Në këtë program studimi janë regjistruar 7 studentë, e dhënë e marrë gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2018-2019, 64 studentë përfunduan me sukses vitin e parë dhe vijuan studimet në vitën e dytë 2019-2020.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020 kanë transferuar studimet pranë këtij programi studimi 6 studentë, përkatësisht 5 në vitin e parë dhe 1 në vitin e dytë.</p> <p>“27. Te dhena tabelore per regjistrimin ecurine”, “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “28. Te dhenat tabelore mbi transferimin e studenteve” dhe “35. Raporti i</p>

	punes vjetore DSLT 2018-2019".
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ evidentoi pas vlerësimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore gjatë vizitës se IAL kryen regjistrimin manual të ecurisë së studentëve të programit të studimit në procesverbalët përkatës dhe regjistrin e notave. GVJ konstaton se institucioni regjistron dhe disponon të dhëna në sekretarinë mësimore për ecurinë e studentëve të programit të studimit "Teknik i Lartë me 3 profile nga pranimi deri në përfundim të studimeve. Aktualisht brezi i parë diplomohet në 2019-2020.</p> <p>Nga sekretaria mësimore regjistrohen manualisht bashkë me të dhënat e tjera të studentëve dhe informacioni mbi punësimin aktual të studentëve. Nga IAL është raportuar se 28 studentë të këtij programi studimi janë të punësuar dhe me referencë të punëmarrësit.</p> <p>"27. Te dhëna tabelore per regjistrimin ecurine", "Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019", "28. Te dhenat tabelore mbi transferimin e studenteve, "29. Te dhenat tabelore mbi punesimin e studenteve" dhe "35. Raporti i punes vjetore DSLT 2018-2019".</p>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL,</p> <p>GVJ konstaton se IAL nuk ka në përdorim një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm ku ruhen, administrohen dhe përpunohen të gjitha të dhënat e studentëve, përfshirë dhe rezultatet e ecurisë në programin e studimit, gjenerimin e raporteve të ndryshme statistikore. Si e tillë siguria e informacionit që administrohet në IAL është e cënuar dhe jo lehtësisht e verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar për studentët e programit të studimit "Teknik i Lartë", në vitin akademike 2018-2019, një raport analitik mbi profilin, cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për cdo semestër. Ndërkohë për vitin 2019-2020 jepen të dhëna statistikore të cilësisë në hyrje, Në raportin vjetor mbahen të dhëna mbi cilësinë e rezultateve në provime dhe hën krahasime me cilësinë në hyrje që është relativisht e ulët, pasi nota mesatare e pranimeve në vitin e parë të 2018-2020 është në 6. Shkalla e punësimit në programin e studimit "Teknik i Lartë", është e lartë.</p> <p>Nga ana e IAL duhet të parashikohen masa të mëtejshme përveç bashkëpunimit me partnerët për praktikat profesionale dhe aftësimin profesional të tyre si pjesëmarrjet në panairët e punës, në aplikime dhe pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe</p>

	ndërkombëtare. “27. Te dhena tabelore per regjistrimin ecurine”, “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “28. Te dhenat tabelore mbi transferimin e studenteve”, “29. Te dhenat tabelore mbi punesimin e studenteve”, “3. Lista studenteve te punesuar KSLP-Teknike” dhe “35. Raporti i punes vjetore DSLT 2018-2019”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit, ku specifikohet qartë përfshirja, angazhimi, si dhe roli i Këshillit studentor, përfshirja dhe angazhimi i përfaqësuesve të studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit. ” 2. Statuti KUB” dhe “5. Rregullore KUB”.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese nëpërmjet përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit, përkatësisht në statusin dhe rregulloren e institucionit. Studentët përfaqësohen përkatësisht në senatin akademik, këshillin e etikës dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). ” 2. Statuti KUB”, “5. Rregullore KUB”, “37 Raport vjetor i publikuar monitorimi i cilesise” dhe “30. Te dhenat tabelore per NJSBC”.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar planin mësimor të përgatitur për programin e

<p>parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>studimit”Teknik i Lartë”, me 3 profile në zbatim të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi sipas përcaktimeve. Në fund të cdo semestri dhe viti akademik nga ana e departamentit përgjegjës është bërë një analizë për të vlerësuar rezultatet e studentëve, problematikat e hasura dhe nevojat për përmirësim. Gjatë vitit akademik 2019-2020 janë transferuar në 6 studentë.</p> <p>“2.Procedure transferimi KSLP”,“28. Te dhenat tabelore mbi transferimin e studenteve” ,“38 Analize e departamentit pergjegjies” dhe “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në këtë program studimi, “Teknik i Lartë”, me 3 profile është realizuar procesi i rishikimit dhe përmirësimit në Mars 2019, deri në 20 % të këtij programi studimi me Vendimin e Senatit Akademik Nr.25 të datës 13.03.2018 dhe është dërguar për njohje pranë MASR sipas përcaktimeve ligjore. Në këtë rishikim të programit të studimit për vitin akademik 2019-2020 nuk ka evidenca për përfshirjen e studentëve në procesin e e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Studentët e këtij programi studimi nuk kanë patur mundësi të japin mendimin e tyre pasi rishikimi është bërë në Mars 2019 kur studentët e regjistruar për herë të parë në këtë program studimi nuk kishin mbaruar akoma vitin e parë të programit të studimit.</p> <p>“Aneks 13 Vendim Senati Plani Mesimor program studimi “, “Anex 17 Relacion i ndryshimit te curriculave te profileve 2019”, “Aneks 18 Vendim senati Mars 2019 Kurrikulat e ndryshuara” dhe “14. Dosja e plote e programit dhe elementet perberes te tij”.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni u mundëson studentëve së pari vënien në dispozicion dhe informimin mbi kriteret dhe procesin e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, “Teknik i Lartë”, me 3 profile në javën e informimit dhe gjatë javës së parë të mësimit për çdo lëndë. Studentëve ju mundësohet nëpërmjet procedurave të rregulluara, pyetsorëve, e drejta e barazisë dhe transparencës në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, si dhe mundësisë së ankimimit të rezultatit, kërkesës për rishikim të tij.</p> <p>“6. Rregullore KSLP”, “7. Rregullore e programit Teknik i Larte”, “40 Pyetsor i studenteve” dhe “Aneks 30 format kerkese per rishikimi te testit te lendes”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



Epalu

[Signature]

Standardi V.5



Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton procedura të veçanta, të përcaktuara që në rregulloren e institucionit, si dhe ka ngritur njësinë përgjegjëse për informimin dhe në shërbim të studentëve, që është Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) me objektiva dhe detyra të mirëpërcaktuara. “5 Rregullore KUB”, “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “51 Politikat e marketingut” dhe “35. Raporti i punes vjetore DSLT 2018-2019”.
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ZSKK funksionon tërësisht në mbështetje të informimit, këshillimit, ndjekjes së përparimit të studentëve dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit, “Teknik i Lartë”, me 3 profile. Krahas saj institucioni zhvillon këshillimin e karrierës në fushatën “E Maturantëve” dhe tour-in e këshillimit pedagog-maturant, në periudhën Gusht - Shtator, ku përveç këshillimit për programet e studimit, ofrohet informacioni për jetën studentore, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen, tarifave dhe modaliteteve të pagesës. Më tej me regjistrimin e studentëve në programin e studimit, ky proces ndiqet nga ZSKK. Një nga programet me interes që prezantohet nga ZSKK është bashkëpunimi i KUB me partnerët e biznesit për praktikat profesionale. “5 Rregullore KUB”, “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “51 Politikat e marketingut”, “35. Raporti i punes vjetore DSLT 2018-2019”, “32. Tabele permblledhese me inst bashkepunuese” dhe “3. Lista studenteve te punesuar KSLP-Teknike”.
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në KUB, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet ZSKK ka ofruar shërbimin e këshillimit të karrierës dhe kujdesin ndaj studentit, duke mbështetur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor,

<p>procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>por dhe në orientimin dhe zgjedhjen e praktikës profesionale, si dhe orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës. Nga kjo zyrë janë krijuar kontakte dhe institucioni ka lidhur marrëveshje me kompani private dhe institucione shtetërore në funksion të praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit të studentëve..</p> <p>“5 Rregullore KUB”, “35. Raporti i punes vjetore DSLT 2018-2019”, “29. Te dhenat tabelore mbi real te studenteve”, “32. Tabele permbledhese me inst bashkepunuese” dhe “3.Lista studenteve te punesuar KSLP-Teknike”.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në KUB, GVJ konstaton se ZSKK, si pjesë e detyrave të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar. Për këtë program studimi nuk ka akoma studentët të diplomuar. ZSKK ka informacion në lidhje me studentët që vazhdojnë këtë program studimi dhe janë njëkohësisht të punësuar.</p> <p>“5 Rregullore KUB”, “Aneks 5 Raporti vjetor KUB viti akademik 2018-2019”, “29. Te dhenat tabelore mbi real te studenteve”, “32. Tabele permbledhese me inst bashkepunuese” dhe “3.Lista studenteve te punesuar KSLP-Teknike”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit (KUB)”

Pikat e forta dhe afirmime



1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtare dhe lokale.
2. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike e duhur në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.
3. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit.

Pika të dobëta

1. Programi i studimit paraqet paqartësi në hartimin e qëllimeve dhe objektivave të tij. Vërehet një kompaktësi e munguar në dokumentacionet, kur janë përcaktuar këto elemente të rëndësishëm të programit të studimit. Këto mangësi reflektojnë paqartësi dhe në vlerën e diplomës në treg, për profesionet e mundshme.
2. Raportet e përcaktuara për personelin akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, nuk plotësohen në asnjë prej profileve të programit të studimit.
3. Personeli i punësuar me kohë të plotë që është i angazhuar me mësimdhënie në tre profilet, për lëndët me natyrë teknike, është i pakët në numër dhe nuk është i punësuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
4. Programi i studimit nuk ka në përdorim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit për studentët, personelin akademik dhe aktivitetin e tij. Në këto kushte siguria e informacionit që administrohet në IAL është e cënuar dhe jo lehtësisht e aksesueshme dhe verifikueshme nga personat e autorizuar.
5. Programi i studimit duhet të ketë më tepër konsistencë në kurrikulat brenda secilit profil, për të qartësuar kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët dhe mundësitë e punësitë të jenë të shprehura qartë.
6. Për disa lëndë specifike të programit të studimit evidentohet në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, mungesa e orëve të mjaftueshme praktike/laboratorike që pajisin studentët me aftësitë praktike, kjo e mbështetur me mjetet përkatëse.
7. Burimi kryesor i financimit të programit të studimit ngelen të ardhurat e siguruar nga tarifat për edukimin dhe shërbimet që paguajnë studentët.
8. Programi i studimit ka mungesë në fondin e bibliotekës.

Rekomandime

1. Njësia bazë dhe ajo kryesore duhet të rregullojnë në mënyrë urgjente raportet mes personelit akademik me kohë të plotë dhe numrit të studentëve, që të qëndrohet brenda kornizës ligjore në fuqi.



2. IAL sugjerohet të ndërmarrë fushata rekrutimi për të përmbushur nevojat me burime njerëzore të angazhuar në lëndët e profileve te programit të studimit me natyrë teknike.
3. Njësia bazë duhet të ndërmarrë iniciativa të tjera në lidhje me aftësimin praktik te studentëve dhe përtej orëve në auditor.
4. Programet lëndore të secilit profil rekomandohen të azhornohen sipas rekomandimeve të dhëna në këtë raport, të përmirësohen literaturat me botime më të reja për një pjesë të lëndëve. Në përgjithësi, të rishihet struktura e profileve, si dhe të konsiderohen nevojat e studentëve për të përvetësuar më shumë pjesë praktike.
5. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit.
6. Të parashikohen dhe shtohen në syllabusin e disa lëndëve specifike në programin mësimor orët praktike/ laboratorike, të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme.
7. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm jo vetëm në nivel institucioni por dhe në nivel programi studimi;



Conclusions of the Evaluation of the professional study program “High Technician” of Institution of Higher Education “Business University College” (KUB)

Strengths and affirmations

1. The study program is designed in compliance with the economic development of the country and meets expectations of the labor market, in accordance with the strategic goals of national and lokal economic development.
2. The convinient premises and appropriate didactic infrastructure available to the study program provides the necessary contemporary spaces and conditions for the education process.
3. The institution has retained new cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation inside and outside the country.

Weak Points

1. The study program presents ambiguity in the alignment of its goals and objectives. A lack of compactness is noted in the documentation, when are defined these important elements of the study program. These deficiencies also have reflected uncertainty in the value of the diploma in the market, for potential professions.
2. The defined ratios for the full-time academic staff / student, where the academic staff must cover not less than 70% of the workload, are not met in any of the profiles of the study program.
3. The full-time personel engaged in education process of three profiles, for courses of a technical nature, is few in number and is not employed in ccompliance with respective legal framework in place.
4. The study program does not have in usage an internal information management system for students, academic personal and its activity. In these conditions, the security of the information administered in the HEI is violated and not easily accessible and verifieable by the authorized persons.

5. The study program should have more consistency in the curricula within each profile, to define the professional competencies that students should attain and job opportunities to be clearly stated.
6. For some specific courses of the study program is evidenced in study program and courses syllabus, the lack of sufficient practical/laboratory hours which equip students with practical skills, supported by suitable tools.
7. The main sources of the study program funding are the income from the students paid fees for education and services.
8. The study program is lacking in the library fund.

Recommendations

1. The basic and the main unit must urgently regulate the ratios full-time academic staff and the number of students, in order to be within the legal framework in place.
2. The HEI is suggested to commence recruitment process to fulfill the needs with respective human resources involved in the courses of study program profiles with a technical nature.
3. The basic unit should take additional initiatives related to the practical training of students and beyond the hours in the auditorium.
4. The subject programs of each profile are recommended to be updated according to the given recommendations of this report, to improve the literature with newer publications for a part of the subjects. In general, a review of profiles structure is required, as well as should be taken in consideration the needs of students to acquire more practice.
5. The institution should be committed on finding other sources for financing the study program.
6. In the syllabus of some specific courses of study program should be foreseen and added practice/laboratory hours, supported by the necessary infrastructure.
7. Involvement of external experts in the processes of internal evaluation should be not only at the institution level, but also at the study program internal evaluation;

Spader

[Signature]

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

